

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2003

Në këtë numër:

E Drejta Kushtetuese

- Akti administrativ, objekt i juridiksionit kushtetues dhe gjyqësor
- Partitë politike dhe financimi i tyre nga shteti
- Përballja e demokracisë me mediat

Reforma ligjore

- Analiza kritike e legjislacionit dhe praktikës shqiptare në vështrim të Kodit të Punës

E Drejta Parlamentare

- Aspekte të funksionimit të kuvendit krahinor në të drejtën dokesore

16

Botim i Qendrës së Studimeve Parlamentare

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XVI, viti 2003

	Faqe
<hr/>	
E Drejta Kushtetuese:	
Akti administrativ, objekt i juridiksionit kushtetues dhe gjyqësor Sokol SADUSHI	4
Partitë politike dhe financimi i tyre nga shteti Arta VORPSI	16
Përballja e demokracisë me mediat Marie-France DELHOSTE	27
<hr/>	
Reforma ligjore:	
Analiza kritike e legjislacionit dhe praktikës shqiptare në vështrim të Kodit të Punës Elta MILORI	45
<hr/>	
E Drejta Parlamentare:	
Aspekte të funksionimit të kuvendit krahinor në të drejtën dokesore Nebi BARDHOSHI	51
Një instrument i ri për rolin mbikëqyrës të parlamentit: zyrat dhe delegacionet (Parlamenti francez)	64
<hr/>	
Nga punimet e Kuvendit:	
Nga punimet e Kuvendit për periudhën tetor-nëntor 2003 Alma KONDAKÇI	73
Informacion mbi legjislacionin e miratuar Filip LAKO	83
<hr/>	
Përmbledhje në anglisht:	
Informacion mbi legjislacionin e miratuar	99
<hr/>	

TABLE OF CONTENTS:

16th issue, year 2003

	Page
<hr/>	
Constitutional Law:	
Administrative act, subject of the constitutional and judicial jurisdiction	
Sokol SADUSHI	4
Political parties and their financing from the state	
Arta VORPSI	16
Endurance of democracy with media	
Marie-France DELHOSTE	27
<hr/>	
Legal reform:	
Critical analysis of legislation and Albanian practice in the view of the Code of Labor	
Elta MILORI	45
<hr/>	
Parliamentary Law:	
Aspects of regional assembly functioning in the custom law	
Nebi BARDHOSHI	51
A new instrument for the supervisory role of the Parliament: offices and delegations (Parliament of France)	64
<hr/>	
From the proceedings of the Assembly:	
From the proceedings of the Assembly for the period October - November 2003	
Alma KONDAKÇI	73
Information on the approved legislation	
Filip LAKO	83
<hr/>	
Summary in English	
Information on the approved legislation	99
<hr/>	

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Akti administrativ objekt i juridiksionit kushtetues dhe gjyqësor

Sokol Sadushi
Anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Nuk dyshoj se mbrojtjen më të plotë të ligjshmërisë së akteve administrative do të mund ta ofronin vetëm gjykatat. Në të vërtetë ato janë në gjendje të vlerësojnë anën e drejtë të veprimtarisë administrative, të shqyrtojnë se a ka vepruar administrata në pajtim me ligjin ose a e ka shkelur dhe sa e ka shkelur ajo normën juridike. Vetë kontrolli administrativ, nga ana e tij, nuk ka mundur të garantojë ligjshmërinë e mjaftueshme dhe të frytshme të akteve administrative. Në këto kushte mbrojtja është dashur që të kërkohet në organet e një pushteti tjetër. Pikërisht është kontrolli gjyqësor, i cili siguron mbrojtjen e ligjshmërisë në funksionimin e administratës shtetërore, si dhe përbën njëkohësisht një garanci kushtetuese për shtetasit për mbrojtjen e të drejtave të tyre nëpërmjet një gjykimi të drejtë, publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Njihet në doktrinën e së drejtës administrative se akti mund të jetë objekt i konflikteve administrative subjektive dhe objektive. Si kriter kryesor për dallimin e këtyre konflikteve shërben lloji i aktit, pra, nëse akti është me përmbajtje individuale apo normative. Pikërisht kjo ndarje ndeshet edhe në legjislacionin tonë, çka bëhet objekt polemikash dhe krijon probleme për praktikën gjyqësore. Pikërisht, paqartësia që ekziston në praktikën administrative dhe gjyqësore është motivi nga niset autori i këtyre radhëve, për të shpalosur mendimin e tij dhe për ta bërë objekt debati.

Sipas nenit 131, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Ndërsa neni 326 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se nuk mund të ngrihet padi në gjykatën e zakonshme për aktet administrative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.

Sipas këtyre dispozitave të sipërcituara, objekt shqyrtimi për Gjykatën Kushtetuese nuk janë të gjitha aktet administrative që nxjerrin organet e pushtetit qendror dhe atyre vendor, por vetëm ato me karakter normativ.

Ky qëndrim përforcohet më shumë dhe nga paragrafi i parë i nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit nuk mund të ngrihet padi në gjykatën e zakonshme për aktet administrative të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës publike të nivelit qendror ose vendor që kanë karakter normativ, përveç kur ato çenojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe interesa të tjerë të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë. Ky përjashtim nënkupton se ligjshmëria e *akteve administrative me karakter individual* do të shqyrtohet nga gjykatat e zakonshme, pavarësisht se këto akte mund të nxirren dhe nga organet më të larta të administratës shtetërore, duke përfshirë Këshillin e Ministrave, Kryeministrin apo dhe ministrin.¹ Megjithatë, ka dhe raste kur Gjykata Kushtetuese bëhet kompetente për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e aktit administrativ me karakter individual. Dhe kjo kompetencë i është dhënë Gjykatës Kushtetuese nga vetë Kushtetuta. Sipas nenit 115 të Kushtetutës: “*Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndalet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës*

¹ Nuk bëjnë përjashtim nga ky trajtim edhe aktet që nxjerr Presidenti i Republikës, pasi në praktikën gjyqësore janë vërejtur rastet kur ato janë bërë objekt i rishikimit gjyqësor nga gjykata e zakonshme.

ose të ligjeve.” Ky vendim që nxjerr Këshilli i Ministrave për shkarkimin ose edhe shpërndarjen e një organi të pushtetit vendor kuptohet që merr natyrë individuale, pasi ka të bëjë me një organ konkret dhe për një çështje konkrete.²

Lënia e këtyre çështjeve në kompetencë për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese vërtet përbën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit ajo gjykon vetëm aktet me karakter normativ, por njëkohësisht duhet kuptuar si një siguri më shumë që i jepet organeve të pushtetit vendor, që ata të gjykohen nga autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës.³

²Kushtetutshmërinë e këtij akti administrativ me natyrë individuale e shqyrton Gjykata Kushtetuese si rrjedhojë e ankimit që mund të paraqesë organi i shpërndarë ose i shkarkuar. Pas shqyrtimit gjyqësor të këtij akti, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Këshillit të Ministrave ose lënien në fuqi të tij dhe rrëzimin e kërkesës. Sipas nenit 115, pika 3 të Kushtetutës: “Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.” Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore nuk mund të shkarkohet ose shpërndahet për çdo lloj shkeljeje që mund të konstatohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, por vetëm për ato shkelje të Kushtetutës e ligjeve, të cilat konsiderohen të rënda.

³ “Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë” Fehmi Abdiu. Një trajtim të tillë e bën autori në librin e tij, nga i cili po shkëpus disa paragrafe: *Gjykimi i çështjeve të tilla që shqyrton Gjykata Kushtetuese lidhur me mosmarrëveshjet të cilat kanë të bëjnë me shpërndarjen ose shkarkimin e organeve të zgjedhura drejtpërdrejt, ka veçoritë e tij. Në përmbajtje ato janë gjykime që kanë të bëjnë me zgjidhjen e një konflikti pune, që si rregull, gjykohet nga gjykata e sistemit të zakonshëm. Në atë proces palët paraqesin pretendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e konfliktit që kanë dhe provat me të cilat vërtetojnë ato... I vetmi ndryshim që vihet re në lidhje me këto çështje është ai që ka të bëjë me faktin që organi, i cili shqyrton këto konflikte është Gjykata Kushtetuese. Kjo kompetencë e Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 115/1 të saj është një përjashtim nga kompetencat që në përgjithësi ka një organ, sipas nenit 131 të Kushtetutës. Ky qëndrim, sipas mendimit tim, ka të bëjë me faktin që Kushtetuta ka veçuar këto konflikte nga konfliktet e tjera të punës për shkak sa të autoritetit të organit që vendos për shpërndarjen ose shkarkimin e tyre, aq dhe të organeve qeverisëse që janë ndëshkuar disiplinarisht.*”

Dallimi midis juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatës së zakonshme, lidhur me shqyrtimin e vlefshmërisë së akteve administrative, qëndron në radhë të parë te karakteri i përmbajtjes së aktit administrativ që i ndan ato në akte normative dhe në akte individuale dhe, *së dyti, te fakti i antikushtetutshmërisë ose paligjshmërisë së aktit.*

Lidhur me këto dy çaste të rëndësishme ka edhe qëndrime të ndryshme, të cilat janë shprehur dhe në veprimtarinë gjyqësore të këtyre organeve. Pikëpamjet e ndryshme lidhen me karakterin e përmbajtjes së aktit dhe me paligjshmërinë apo antikushtetutshmërinë e aktit. Në këtë drejtim lindin disa pyetje, që u duhet dhënë përgjigje, të cilat nuk mendoj se duhet të mbeten pa opsionin e kundërt.

Pyetja e parë: *“Një akt administrativ me detyrime të përgjithshme, pra, normativ që nxjerr Qeveria dhe organet e tjera qendrore ose vendore të administratës, i cili çënon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e ligjshme të një shtetasi, do të jetë objekt shqyrtimi i juridiksionit të gjykatave të zakonshme apo i Gjykatës Kushtetuese?”*

Duke iu referuar paragrafit të parë të nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile konkludohet se nuk mund të ngrihet padi në gjykatën e zakonshme për aktet normative që nxjerr Këshilli i Ministrave dhe organet e tjera të pushtetit vendor. I vetmi përjashtim, sipas të cilit mund të ngrihet padi në gjykatë, ekziston për ato akte administrative, *të cilat çënojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve.* Pikërisht, përjashtimi i mësipërm krijon mendime të ndryshme mbi mënyrën e të interpretuarit të kësaj dispozite.

Me interpretimin literal të dispozitës konkrete, të krijohet përshtypja e parë se, përderisa parashikohet një përjashtim, ai duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm. Por duke bërë një interpretim të zgjeruar të dispozitës, kufizimi i vendosur në këtë paragraf, lidhur me pamundësinë për t’iu drejtuar gjykatës së zakonshme për aktet normative të qeverisë, kthehet në një të drejtë për t’iu drejtuar gjykatës për çdo akt normativ të qeverisë.

Përjashtimi ligjor i parashikuar në dispozitën konkrete *“...se përveç atyre*

*akteve që cënojnë të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve”, jo vetëm që mbetet veçse një tautologji dhe krijon konfuzion në kuptimin e dispozitës, por, praktikisht, bëhet edhe i pazbatueshëm. Nëse ligji nuk i lejon, por i ndalon shtetasit t’i drejtohen gjykatës së zakonshme për aktet normative që nxjerr qeveria (përveç atyre që i cënojnë këto shtetas), atëherë ky ndalim, i parashikuar si i tillë, nuk mund të qëndrojë më për asnjë rast, sepse nuk mendohet se mund të ketë akte administrative normative **që nuk cënojnë interesat e ligjshme të dikujt**. Nuk mund të kuptohet ekzistenca e një akti normativ që vendos rregulla të detyrueshme sjelljeje për subjektet e ndryshme dhe të pretendosh se ky akt mund të mos cënojë askënd. Çdo akt sjell një detyrim, ose edhe cënim, pavarësisht se ky cënim qëndron ose jo nga pikëpamja ligjore.⁴*

Pra, sipas dispozitës procedurale, kur qeveria ka nxjerrë një vendim të saj me karakter normativ që ka cënuar ose ekziston një mundësi cënimi në potencë ndaj dikujt ose një kategorie të caktuar subjektsh, atëherë këtyre subjekteve u lind e drejta t’i drejtohen gjykatës së zakonshme për pavlefshmërinë e aktit konkret.

Nga një dispozitë, në vështrim të parë ndaluese, ajo kthehet në një normë lejuese, e cila nuk arrin të saktësojë çështjet për të cilat nuk mund të bëhen padi, përkundrazi, i krijon mundësi interpretimit se, meqenëse çdo akt normativ prek një interes të një individi të caktuar, atëherë edhe ky akt do të shqyrtohet nga gjykata e zakonshme. P.sh., Këshilli i Ministrave nxjerr një vendim me karakter normativ në zbatim të ligjit për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve. Ky vendim

4. Koncepti i legjitimitimit për të filluar një procedim administrativ është i parashikuar qartë në nenin 45 të K.Pr.A, ndërsa neni 325 i K.Pr.Civile i njeht të drejtën kujtdo që i cënohen interesat e tij të ligjshme që t’i drejtohet gjykatës së zakonshme për paligjshmërinë e një akti administrativ.

parashikon rregulla sjelljeje të detyrueshme për mënyrën e privatizimit të objekteve shtetërore që ndodhen në pronën e ish-pronarëve dhe njëkohësisht pretendohet nga të interesuarit se cënon dhe të drejtat e tyre si ish-pronarë për privatizimin e këtyre objekteve. Ky vendim i qeverisë është një akt administrativ me detyrime të përgjithshme, pra, akt normativ. Atëhere, sipas nenit 326, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, meqenëse ky akt normativ i qeverisë cënon interesat e ligjshme qoftë dhe të një ish-pronari, pra, të një shtetasi, ai duhet t'i drejtohet gjykatës së zakonshme. Prandaj lind për diskutim pyetja: A është kompetente gjykata e zakonshme për të shqyrtuar këtë akt normativ të qeverisë?

Pavarësisht se dispozita procedurale është e formuluar në atë mënyrë, siç e cituam më lart, mendoj se për të pasur një kuptim më të drejtë për shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre dhe për të arritur të krijojmë një praktikë normale, do të arsyetoja duke u nisur nga një interpretim i zgjeruar i dispozitës konkrete, duke e parë atë në tërësi me nenin 326 të këtij Kodi.

Qëllimi i formulimit të paragrafit të parë të nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile nga ana e ligjvënësit mendoj se ka qenë për të dalluar aktet me karakter normativ nga ato me karakter individual. Këtë dallim ai e ka shprehur brenda kuptimit të paragrafit të parë, sipas të cilit të gjitha aktet administrative të nxjerra nga qeveria dhe organet e tjera administrative që përmbajnë detyrime të përgjithshme janë me karakter normativ, por njëkohësisht, duke qenë të tilla, ato nuk mund të atakohen në gjykatën e zakonshme.

Kur ndodhemi përpara akteve me natyrë normative, të cilat e shtrijnë efektin e tyre në të gjithë Republikën, e drejta e shqyrtimit të vlefshmërisë së tyre duhet t'i përkasë një organi të vetëm që vepron në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Jo pa qëllim paragrafi i dytë i nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile, ka parashikuar se ka akte administrative, shqyrtimi i të cilave është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Pikërisht sipas nenit 131, shkronja “c” të Kushtetutës, kjo gjykatë shqyrton pajtueshmërinë e akteve normative

të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Ligji nuk mund të parashikojë ose të lejojë që vlefshmëria e një akti administrativ me karakter normativ të bëhet objekt shqyrtimi njëkohësisht i juridiksionit gjyqësor dhe i juridiksionit kushtetues. Akti duhet të shqyrtohet vetëm nga një organ. Paragrafi i parë i nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile duhet kuptuar dhe njëkohësisht interpretuar në këndvështrimin se gjykata e zakonshme do të jetë kompetente vetëm për shqyrtimin e akteve administrative me karakter individual që nxjerr qeveria dhe organet e tjera qendrore ose vendore të administratës dhe jo të atyre me karakter normativ; pra të gjitha atyre akteve që nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me moskuptimin e drejtë të juridiksionit të gjykatave lind *pyetja e dytë: Aktet normative që nxjerr qeveria ose organet e tjera vendore, për të cilat nuk ka pretendime për antikushtetutshmëri, por për paligjshmëri, cilit juridiksion do t'i nënshtrohen ?*

Problemi shtrohet në përcaktimin e organit kompetent që shqyrton *paligjshmërinë e aktit normativ*, pasi dihet që në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vlerëson vetëm antikushtetutshmërinë e aktit.⁵

Në dallim nga “Dispozitat Kryesore Kushtetuese” dhe nga shumë kushtetuta europiane, të cilat kanë parashikuar të drejtën e Gjykatës Kushtetuese të vendosë për papajtueshmërinë e akteve nënligjore normative me Kushtetutën, *por dhe me ligjet* (pra, jo vetëm për

⁵. I vetmi përjashtim kur Gjykata Kushtetuese shqyrton përveç antikushtetutshmërisë së aktit edhe *paligjshmërinë* e tij, të cilën e trajtuam më lart, është parashikuar në nenin 56 pika 2 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH”. Sipas këtij neni: “Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë ose paligjshmërinë e aktit”.

antikushtetutshmërinë, por edhe për paligjshmërinë), Kushtetuta e RSH-së, këtë të drejtë e ka kufizuar. Neni 131, shkronja “c” parashikon vetëm shqyrtimin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën, duke mos përmendur mospërputhjen e tyre me ligjet. Mendoj se ky çast, i cili është mjaft i rëndësishëm, të krijon në vështrim të parë idenë e një ometimi konstitucional, për arsye se aktet normative që mund të bien në kundërshtim me ligjet, i lë jashtë kontrollit gjyqësor.

Për të kuptuar se përgjigja e pyetjes së mësipërme nuk ka vetëm karakter teorik, por paraqitet si një zgjidhje e domosdoshme që ndeshet në praktikën administrative dhe atë gjyqësore, po marr për ilustrim rastin e mëposhtëm. Mbi bazën e një ligji konkret, Këshilli i Ministrave nxjerr një vendim me karakter normativ nëpërmjet të cilit rregullon në mënyrë të hollësishme marrëdhënie të caktuara juridike. Në këtë rast, ndaj këtij vendimi, pavarësisht se nuk gjenden lehtë argumentet për antikushtetutshmëri, mund të arsyetohet në drejtim të paligjshmërisë. Megjithatë, shqyrtimi i pavlefshmërisë së tij do të mbetet jashtë juridiksionit, qoftë të Gjykatës Kushtetuese, pasi, siç dihet, ajo shqyrton antikushtetutshmërinë e akteve normative dhe jo paligjshmërinë e tyre⁶, ashtu dhe të gjykatave të zakonshme, pranë të cilave nuk ngrihet padi për aktet normative.

Nga një vështrim sipërfaqësor i përmbajtjes së aktit normativ të krijohet përshtypja se ai mund të ketë tejkaluar caqet e ligjit. *Pikërisht, shtrohet pyetja se paligjshmërinë e këtij akti normativ, kush duhet ta zgjidhë?* Jam i mendimit se edhe kjo çështje e ka zgjidhjen e saj. Në këtë aspekt

⁶ Përjashtim, të cilin e kam përmendur më lart, bëhet vetëm në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve, ku sipas nenit 56 pika 2 të ligjit bazë, Gjykata Kushtetuese shqyrton përveç antikushtetutshmërisë edhe paligjshmërinë e aktit.

paraqiten dy zgjidhje të ndryshme.

Zgjidhja e parë lidhet me të drejtën e individit për të rivënë në vend të drejtën e shkelur padrejtësisht. Nëse dikush preket nga një akt i tillë normativ, atëherë duhet të pritët deri sa ky akt i përgjithshëm të detajohet në një akt individual për personin konkret që do t'i drejtohet. Kjo kërkon nxjerrjen e aktit individual nga organi që do të rregullojë në mënyrë specifike rastin. Atëherë kur akti individual të ketë prodhuar efekte juridike, individi i drejtohet gjykatës së zakonshme, e cila shqyrton ligjshmërinë e aktit individual. Megjithatë, edhe në këtë rast çështja nuk zgjidhet përfundimisht sepse, pavarësisht se individi e zgjidh të drejtën e tij të shkelur nëpërmjet rishikimit të aktit administrativ nga gjykata e zakonshme, mbetet pa zgjidhur kontrolli i ligjshmërisë së aktit normativ, i cili mbetet i paprekur.

Për **zgjidhjen e dytë** të kësaj çështjeje mendoj se ka vend për zbatimin e nenit 118, pika 2 të Kushtetutës. Sipas këtij formulimi kushtetues, "*Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*" Ky nen kushtetues ka kufizuar të drejtën e organeve administrative që të nxjerrin akte nënligjore në ato raste kur ligji nuk ia ka njohur në mënyrë të shprehur këtë të drejtë. Pra, në njëfarë mënyre ky nen kushtetues, duke parashikuar kushtetutshmërinë e aktit normativ, përcakton edhe kushtet e ligjshmërisë së tij. Asnjë akt normativ nuk mund të tejkalojë caqet e ligjit. Nëse organi administrativ nxjerr një akt normativ tej hapësirës së ligjit (pra, kur nuk respekton katër kriteret kryesore që jep kjo dispozitë kushtetuese), është e kuptueshme se akti do të jetë i paligjshëm, por njëkohësisht edhe antikushtetues. Pra, mosrespektimi i kërkesave të nenit 118 pika 2 e bën aktin normativ të paligjshëm, por edhe antikushtetues. Dihet se kushtetutshmërinë e aktit normativ e kontrollon Gjykata Kushtetuese. Kështu që në këtë rast është e pashmangshme përputhja e koncepteve të paligjshmërisë me ato të antikushtetutshmërisë. Pranimi si i drejtë i këtij

arsyetimi zgjidh edhe paqartësinë që paraqitet në praktikën gjyqësore, lidhur me mundësinë e rishikimit gjyqësor të akteve normative.

Gjatë një analize të tillë shtrohet për diskutim edhe një *pyetje tjetër* që ka të bëjë me rastin se *kur një akt administrativ individual që nuk atakohet si i paligjshëm, por si antikushtetues, a mund të shqyrtohet nga gjykata e zakonshme?*

Nëse do të hidhnim një vështrim në përvojat kushtetuese të vendeve demokratike, do të vërejmë se rishikimi gjyqësor është konsoliduar në dy mënyra. Njëra mënyrë është sipas *parimit të traditës amerikane (rishikimi i shpërndarë)*, nëpërmjet të cilit çdo gjyqtar ka detyrimin e tij kushtetuese, që në rast se gjatë veprimtarisë së tij gjyqësore ndeshet me ligje ose akte administrative, për të cilat ka bindjen se janë të kundërligjshme, ose me karakter antikushtetues, ai nuk i zbaton ato, duke ju referuar drejtpërsëdrejti kushtetutës.

Mënyra tjetër është sipas *parimit të traditës së kontinentit, pra, asaj europiane (rishikimi i përqendruar)* që nënkupton ekzistencën e një organi të lartë dhe të ndarë nga gjykatat e zakonshme, i cili kontrollon pajtueshmërinë e ligjit ose të aktit juridik me Kushtetutën. Ky funksion i kontrollit kushtetues

7. Në këte paragraf të nenit 145 duket sikur kanë gjetur shprehjen e tyre të dy parimet, qoftë ai i rishikimit të shpërndarë, ashtu dhe ai i rishikimit të përqendruar. Shprehja e përdorur në fjalinë e parë, se “*kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato...*”, është dhënë në një kuptim kategorik që nuk lë vend për interpretime të mëtejshme. Sipas këtij paragrafi, gjyqtari ka të drejtën, por njëkohësisht nënkuptohet si detyrim kushtetues, që ligjet, të cilat i konsideron si antikushtetuese, ai nuk duhet t’i zbatojë. Megjithatë kuptimi i dispozitës nuk mund të merret i veçuar, por duhet interpretuar në tërësinë e saj, sipas të cilës, gjyqtarët në këto raste duhet të pezullojnë gjykimin dhe t’ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese, që është i vetmi organ që garanton kushtetutshmerinë e ligjeve.

sipas mënyrës së dytë kryhet nga Gjykata Kushtetuese. Parimi i kontinentit ka gjetur sanksionimin e tij në nenin 145 të Kushtetutës së RSH-së, sipas të cilit: “Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese”.⁷

Më lart parashtrova kuptimin e nenit 326 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit nga gjykatat e zakonshme aktet administrative normative, por vetëm ato me karakter individual. Gjithashtu, ka dhe akte administrative individuale, që nxjerr Këshilli i Ministrave, Kryeministri ose ministrat, të cilat mund të konsiderohen me karakter antikushtetues, shqyrtimin e të cilave nuk mund ta kryejë dot gjykata e zakonshme, sepse ne kemi pranuar parimin e kontinentit, pra, të rishikimit të përqendruar nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese. Njëkohësisht, qenia e tyre akte individuale i nxjerr jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.⁸

Përgjigjen e pyetjes do ta kërkoja tek arsyetimi i përdorur më lart për kuptimin që paraqet neni 118/2 i Kushtetutës, por këtë rast në një aspekt të kundërt. Më lart përdora argumentin e paligjshmërisë së akteve normative në funksion të vërtetimit të antikushtetutshmërisë, me qëllimin e vetëm për të përcaktuar organin kompetent. Në këtë rast do të ideoja mendimin se antikushtetutshmëria e një akti individual është e nevojshme të orientohet dhe arsyetohet në drejtim të vërtetimit të paligjshmërisë së tij. Dhe është e

⁸. Rasti kur Gjykata Kushtetuese përjashtimisht nga rregulli i përgjithshëm shqyrton antikushtetutshmërinë e një akti administrativ me natyrë individuale të Këshillit të Ministrave parashikohet në nenin 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: “*Organi i shkarkuar ose i shpërndarë mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet*”. Kjo e drejtë e Gjykatës Kushtetuese buron nga një dispozitë konkrete e zbatohet vetëm për këtë natyrë çështjesh dhe përbën njëkohësisht një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i sanksionuar në nenin 131 shkronja “c” të Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve me natyrë normative dhe jo të atyre individuale.

kuptueshme se antikushtetutshmëria e një akti nuk e përjashton paligjshmërinë e tij. Pra, akti, duke qenë antikushtetues, është në vetvete edhe i paligjshëm. Një arsyetim i tillë mendoj se i vlen përcaktimit të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor për aktet e kësaj natyre. Megjithatë, detyrë e gjykatës së zakonshme mbetet vetëm shqyrtimi i paligjshmërisë së aktit dhe jo i kushtetutshmërisë së tij. Nëse do të rezultonte se akti administrativ kishte respektuar kërkesat e një ligji, por me përmbajtje antikushtetuese, atëherë çështja do të merrte një rrugë tjetër. Do të atakohej ligji për antikushtetutshmëri në Gjykatën Kushtetuese dhe në këtë mënyrë do të zgjidhej edhe fati i aktit individual.⁹

Të gjitha këto çështje të ngritura mbeten objekt diskutimi. Për sa kohë që ligji nuk jep në mënyrë të prerë dhe të qartë zgjidhjen e pyetjeve që shtrohen, atëherë është jurisprudenca gjyqësore ose kushtetuese rruga e vetme që konsolidon dhe unifikon qëndrimin në këtë drejtim.

⁹. Megjithatë, pavarësisht nga këto paqartësi juridike që krijohen për aktet normative të kundërligjshme ose për aktet individuale antikushtetuese, që duken sikur mbeten jashtë kontrollit gjyqësor të tyre, mund të them se është edhe kontrolli i organeve më të larta administrative ose dhe të pushtetit legjislativ, që nëpërmjet akteve që ato nxjerrin të mund të ushtrojnë të drejtën e shfuqizimit ndaj tyre. Pra, megjithëse duken sikur mbeten të pamundura ose objekt diskutimi, për t' u shqyrtuar nga gjykatat, këto akte nuk do t' i shmangen kontrollit të tyre hierarkik, nëpërmjet shfuqizimit nga organet më të larta.

Partitë politike dhe financimi i tyre nga shteti - Vështrim kushtetues

Dr. Arta Vorpsi
Gjykata Kushtetuese

I. FUNKSIONI DHE POZITA E PARTIVE POLITIKE

Neni 9 i Kushtetutës shqiptare i jep *rang kushtetues* institutit të partive politike. Një hap i tillë erdhi si pasojë e reflektimit të procesit politik në Shqipërinë paskomuniste, e cila dëshironte të ndërtonte një shtet që do të funksiononte mbi baza demokratike. Parimi i demokracisë i pasqyruar në dispozitat kushtetuese¹ na dikton se populli nuk mund të përfaqësohet si shumë e vullneteve të secilit prej anëtarëve të këtij grupi dhe as si një bashkësi ideale përballë shtetit për të përçuar vullnetin e tij. Ai del si një grupim i mendimeve, interesave dhe qëllimeve të ndryshme, të cilat bazohen dhe realizohen sipas parimit të pluralizmit, i cili funksionon sipas teorisë se asnjë qëndrim nuk mund të përfaqësojë të vërtetën dhe drejtësinë absolute. Për këtë arsye formohen grupime të ndryshme për realizimin e ideve dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta në formën e partive politike që njihen sot.

Partitë politike janë faktorë qëndrorë të formimit të mendimit dhe vullnetit të lirë të njerëzve, pasi bashkësi më të mëdha individësh që do të kontribuonin në formimin e vullnetit të lirë pa organizma të tillë nuk do të ishin të frytshme për demokracinë. Partitë politike luajnë rolin ndërmjetës midis qytetarit dhe

¹ Neni 2 i Kushtetutës.

organeve shtetërore në një demokraci, rol i cili realizohet edhe nëpërmjet zhvillimit të fushatave zgjedhore për formimin e parlamentit nga i cili del edhe qeveria. Pra, mund të thuhet përfundimisht se partitë politike janë pjesëtare të formimit të vullnetit të popullit, të cilin ato (partitë) përpiqen ta transformojnë në vullnet shtetëror². Kjo u jep atyre *karakter krijues*.

Organet shtetërore në marrjen e vendimeve kanë nevojë për partitë politike për t'u bërë më të kuptueshme në popull, si dhe për të pasur mundësi të përligjin vendimet e tyre. Për këtë arsye partitë konsiderohen edhe si *faktorë integrimi*. Partitë politike marrin edhe një funksion tjetër në vendet me sistem mazhoritar zgjedhjesh, ku shpesh formimi i organeve shtetërore realizohet nëpërmjet krijimit të *koalicioneve* mes partive politike.

Veprimtaria e partive politike mbështetet në *parimin e konkurrencës*, e cila realizohet nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike në një shtet të caktuar. Parimi i konkurrencës nuk vepron vetëm gjatë zgjedhjeve, por edhe pas marrjes së pushtetit nga forca politike më e madhe, gjë që lidhet pikërisht me faktin e mosshpërdorimit të sistemit të pluralizmit dhe garës politike edhe gjatë periudhës midis dy zgjedhjeve. Gjithsesi, parimi i sipërpërmendur duhet të zbatohet duke respektuar ligjet e një rendi demokratik, por, para së gjithash, të drejtat themelore të shtetasve, pasi në fund të fundit janë ata që japin pëlqimin dhe vullnetin e tyre në ndërtimin e shumicës qeverisëse. Që ta quash një proces politik të lirë nuk mjafton vetëm të jetë i shkëputur nga shteti, por edhe të mos jetë nën ndikimin e forcave shoqërore dhe ekonomike deri në atë masë sa të ndikojë dukshëm në procesin politik³. Pikërisht kjo është çështja që shqetëson sot disa prej vendeve demokratike, të cilat ndodhen midis dilemës së lirisë së veprimtarisë së partive politike dhe kontrollit mbi ndikimet e jashtme në rolin e tyre.

² Jellinek, Staatsrecht (Allgemeiner Teil) (1998) fq.545.

³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane BverfGE 7, 198 (208).

II. PARTITË POLITIKE PËRBALLË SHTETIT

Statusi kushtetues i partive politike mund të shihet si shuma e kërkesave që duhet të përmbushin ato për të realizuar funksionin e tyre në demokraci⁴. Prej këtej mund të nxirret se konkurrenca midis partive është mjeti për të arritur një drejtim demokratik të shtetit. Ky drejtim nuk mund të realizohet, nëse shteti e cenon këtë konkurrencë midis partive, duke i çuar ato nga një funksionim demokratik në një autoritar. Për këtë arsye shteti duhet të garantojë *lirinë e veprimit të partive*, e cila ndryshon nga liria e veprimit të shtetasve, si e drejtë themelore kushtetuese, pasi liria e personit nuk ka të bëjë me kryerjen e një funksioni social. Por kjo nuk do të thotë se partitë politike nuk gëzojnë liri e të drejta themelore: përderisa ato janë formacione të lira shoqërore, gëzojnë të drejtat që rrjedhin nga Kushtetuta si subjekte të tilla⁵. Pra, shteti i ka garantuar lirinë e krijimit dhe veprimit partive politike, por kuptohet, një gjë e tillë nuk është e pakufizuar. Të mos harrojmë të drejtën e shtetit për të ndaluar së vepruari një parti politike për shkak të ideve dhe veprimtarisë së saj që mund të mos përputhet me parimet demokratike të funksionimit të shtetit⁶. Në këtë kuadër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka njohur kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të çmuar kushtetutshmërinë e veprimtarisë së partive politike⁷.

Njëkohësisht shteti duhet të garantojë edhe *barazinë midis partive*, para së gjithash duke qëndruar në pozicion asnjësie gjatë procesit të konkurrencës midis partive. Një gjë e tillë natyrisht nuk është e lehtë për organet shtetërore, pasi vetë partitë nuk paraqiten njëllor; ato kanë programe

⁴ Hesse, Die verfassungsrechtliche Stellung der Parteien im modernen Staat, 27.

⁵ Neni 16/2 i Kushtetutës.

⁶ Neni 9/2 i Kushtetutës.

⁷ Neni 131/d i Kushtetutës ndërthurur me nenet 57, 58, 59, 60 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

të ndryshme, anëtarësime, forcë financiare dhe numër zgjedhësish të ndryshëm nga njëra-tjetra. Kjo pabarazi midis tyre krijohet si rrjedhojë e një procesi të lirë dhe të hapur politik. Pra, theksoj se asnjëherë e shteti duhet të konsistojë në faktin që vetë shteti të mos ndikojë në krijimin e gjendjes së ndryshme në të cilën ndodhen partitë politike, si rrjedhojë e një procesi politik demokratik. Në këtë mënyrë barazia midis partive është një *barazi formale* e garantuar me Kushtetutë⁸.

Parimi i barazisë e gjen zbatimin kryesor te gara zgjedhore midis partive politike. Nga ky parim rrjedh se shteti duhet të kujdeset sa i përket zhdukjes së mundësive që krijojnë falsifikime ose rezultate fiktive gjatë votimit. Po kështu, edhe aspekte të tjera, si vënia në dispozicion e lokaleve të caktuara për zhvillimin e tubimeve ose të takimeve formale me zgjedhësit apo anëtarët e partisë, garantimi i hapësirave publicitare për të bërë fushatë etj., janë aspekte ku shteti duhet të garantojë trajtim të barabartë mes partive politike. Është për t'u përmendur vendimi i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë, i cili e quajti veprimin e Qeverisë Gjermane për të garantuar të drejtën e transmetimit të fushatës zgjedhore vetëm të partive parlamentare si antikushtetues, pasi cenon parimin e barazisë dhe të krijimit të mundësive të njëjta partive politike, pavarësisht kuorumit që kanë në përbërje ose përfaqësimit në parlament⁹.

Ligjvënësi shqiptar u ka garantuar partive politike përdorimin e pasurive e mjediseve të tyre për veprimtari ekonomiko-shoqërore të karakterit të botimeve, shtypshkrimeve, shërbimeve ose dhënies me qira, sipas legjislacionit në fuqi, duke i dhënë mundësinë e përfitimit të të ardhurave shtesë për ushtrimin e veprimtarisë së saj politike¹⁰. Gjithashtu, shteti ka lehtësuar

⁸ Neni 9/1 dhe 18/1 i Kushtetutës. Nuk ka gjetur deri tani zbatim në praktikë.

⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane BVerfGE 7, 99; 13, 204.

¹⁰ Neni 20/2 i ligjit "Për partitë politike".

veprimtarinë e partive politike, duke iu njohur të drejtën e përdorimit pa shpërblim të mjeteve të informimit masiv publik në rast fushatash zgjedhore dhe referendumesh, si dhe pajisjen me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore¹¹.

III. Financimi i partive politike

Të gjitha parimet e përmendura më sipër, si parimi i lirisë së veprimtarisë së partive, parimi i barazisë ndikohen nga një aspekt i rëndësishëm: *ai i financimit*. Çështja e parë që shtrohet për diskutim në rast të financimit privat të partive është ai i lirisë së brendshme të organizimit të tyre, e garantuar kjo nga dispozitat kushtetuese. Partitë politike janë person juridik. Ato kanë pasuri për kryerjen e veprimtarisë së tyre, mjetet e propagandës, si dhe institucionet përkatëse realizuese të tyre¹². Financimi nga shteti i partive politike, si në formë të drejtpërdrejtë, pra, të ndihmës financiare, ashtu dhe të tërthortë, mostatimi i dhurimeve të ndryshme etj., shtrojnë çështjen e lirisë së veprimtarisë nga jashtë dhe të parimit të dhënies së shanseve të barabarta¹³. Burimi i tretë i financave të partive, ai i kuotave të anëtarëve, nuk paraqet probleme të natyrës kushtetuese, pasi përbën dhe pjesën më të vogël të të ardhurave krahasuar me dy të parat.

Duhet bërë një dallim midis financimit të përhershëm dhe financimit nga shteti të partive politike vetëm në prag zgjedhjesh. Gjykata Kushtetuese Federale gjermane ka ndaluar financimin e përhershëm të partive politike gjatë gjithë veprimtarisë së tyre nga fondet e shtetit¹⁴. Neni 21 paragrafi 1 i Kushtetutës gjermane përcakton strukturën e partive si grupime të pavarura konkurruese që mbështeten në burimet e tyre dhe ndalon kthimin e tyre në

¹¹ Neni 22 i ligjit për partitë politike. Parashikohet edhe klauzola e përballimit të qirasë së ndërtesës nga shteti kur është e pamundur të bëhet nga vetë partia.

¹² Neni 16 i ligjit nr.8580, datë 17.0.2000 "Për partitë politike".

¹³ *Benda/Maihofer/Vogel*, Handbuch des Verfassungsrechts (1994) 631.

¹⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane, 19 korrik 1966.

subjekte të varura tërësisht nga financimi i përhershëm i shtetit. Shembulli gjerman na tregon se financimi i partive politike në mënyrë të vazhdueshme nga shteti nuk është i detyrueshëm, kjo për vetë faktin se ka faturë të madhe për buxhetin e shtetit. Masa e financimit duhet të jetë “e arsyeshme” dhe së fundmi të mos i kalojë kufijtë e mjeteve financiare që ka arritur të sigurojë partia në rrugë të tjera¹⁵.

Arsyetimi i vendimit të mësipërm konsiston në faktin se ligjvënësi ka përcaktuar qartë se është për një rend themelor demokratik dhe liberal, ku të mbizotërojë shprehja e lirë e vullnetit dhe e mendimit të popullit. Me këtë postulat nuk përputhet financimi i tërë veprimtarisë politike të partive nga shteti. Natyrisht, ndihma fillestare, që mund t’u japë shteti partive në çastin e krijimit, mund të garantojë deri diku trajtimin e barabartë të tyre¹⁶. Në një rast të kundërt partitë politike do të ktheheshin ngadalë në institucione buxhetore, duke vendosur kështu një lidhje varësie ndaj shtetit, ç’ka nuk përputhet me funksionin e partive politike si entitete të pavarura dhe demokratike.

Vullneti i popullit dhe ai i shtetit janë të ndërthurura me njëri-tjetrin. Në një sistem demokratik duhet që vullneti të burojë nga populli dhe t’i drejtohet organeve të shtetit dhe jo anasjelltas. Organet e shtetit formohen si rrjedhojë e vullnetit të popullit, të shprehur në procesin zgjedhor, pra atyre u ndalohej të përzihen në këtë proces, i cili duhet të mbetet i lirë nga ndikimet e shtetit. Ndikimet nga ana e organeve shtetërore janë të lejueshme vetëm në rastet kur bëhen me bazë dhe arsyetim legjitim e kushtetues. Të lejueshme janë p.sh. ndikimet që mund të rrjedhin nga organizimi, në përputhje me

¹⁵ Janë disa vendime të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane që kanë detyruar të vendoset një praktikë e tillë, duke mos e konsideruar atë si diskriminim të partive nga shteti.

¹⁶ Ligjvënësi shqiptar ka parashikuar shumën prej 100.000 lekësh për çdo parti pas regjistrimit në gjykatë si dhe financimin e partive që marrin pjesë në garën zgjedhore (neni 18 i ligjit “Për partitë politike”).

Kushtetutën, i procesit zgjedhor për formimin e vullnetit të popullit. Marrëdhëniet midis organeve kushtetuese dhe partive politike garantohen veçanërisht nga normat kushtetuese që parashikojnë formimin e hapur dhe të lirë nga ndikimet e shtetit të vullnetit të popullit përballë organeve shtetërore.

E drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e shprehjes së vullnetit politik nuk kufizohet vetëm me të drejtën e votës gjatë zgjedhjeve, por dhe me ndikimin që kanë në procesin e vazhdueshëm të formimit të mendimit politik dhe publik. Mendimi publik ndikon në procesin e vendimmarrjes së organeve shtetërore. Gjithashtu, edhe grupimet, shoqatat dhe organizatat e natyrave të ndryshme përpiqen të ndikojnë në vendimet e qeverisë dhe të institucioneve ligjvënëse në interes të anëtarëve të tyre. Para së gjithash janë partitë politike ato që në periudhën mes zgjedhjeve kanë më shumë ndikim në vendimet e organeve kushtetuese, në mënyrë të veçantë në vendimet e parlamentit.

Pikërisht nisur nga këto, duhet shteti mund të ndihmojë financiarisht partitë politike në prag zgjedhjesh, duke u nisur nga tri kritere të qarta dhe lehtësisht të çmueshme: *përqindja e fituar në zgjedhjet e fundit, anëtarësia, vëllimi i donacioneve*. Këto elemente janë treguese të fuqishme dhe reale të njohjes dhe pranimin të partive nga shoqëria dhe garantojnë atë që është më e rëndësishme: pra, që masa e financimit nga shteti të partive vendoset parimisht nga vetë zgjedhësit, pasi janë ata që përcaktojnë tërthorazi forcën e një partie politike. Për rastin shqiptar një zgjidhje e tillë është e gjetur nisur nga fakti se numri i partive politike që financohen nga shteti rritet çdo vit ndjeshëm, pavarësisht se një pjesë jo e vogël e këtyre partive politike shqiptare nuk luajnë rol në politikën e vendit. Një gjë e tillë bëhet më e nevojshme po t'i referohemi edhe gjendjes aktuale të Buxhetit të Shtetit.

Në Buxhetin e Shtetit parashikohet ndihma financiare për kryerjen e veprimtarive vjetore të partive politike, sipas të cilit 70 për qind e ndihmës shtetërore ndahet në pjesë të barabarta sipas votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare, pa kufi të poshtëm, çka nënkupton që çdo parti merr

një mbështetje financiare për votat që ka fituar. Kjo nuk kërkon domosdoshmërisht të ketë deputet në Kuvend, ndërkohë që 20 për qind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive që kanë grup parlamentar dhe 10 për qind e ndihmës shtetërore ndahet në mënyrë të barabartë midis partive që kanë marrë pjesë në dy zgjedhjet e fundit parlamentare me lista kombëtare¹⁷. Ç'rrugë ndiqet me ato parti, të cilat prej vitesh nuk arrijnë të përfaqësohen apo të luajnë rol të dukshëm në politikën shqiptare? Përgjigjja duhet të jetë: partitë që nuk përfaqësohen në dy zgjedhje parlamentare me lista kombëtare nuk duhet të përfitojnë më ndihma nga shteti. Sipas legjislacionit shqiptar burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga: a) kuotat e anëtarësisë; b) çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme; c) ndihma financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit, të miratuar me ligj nga Kuvendi¹⁸.

Lidhur me marrëdhëniet financiare midis organeve kushtetuese dhe partive politike vlen parimi, se shteti nuk është i detyruar të marrë masa, që nevojat monetare të partive politike të plotësohen krejtësisht dhe që, gjithashtu, nuk është i detyruar që mundësitë e ndryshme që kanë partitë politike për të ndikuar në procesin e formimit të vullnetit dhe mendimit politik të popullit t'i garantojë me mjete financiare ose të tjera¹⁹.

Një detyrim i shtetit për të ndihmuar partitë financiarisht nuk del nga fakti se partitë, që ndikojnë në formimin e vullnetit politik të popullit, detyrimisht luajnë rolin e një organi kushtetues. Neni 21 i Kushtetutës gjermane i ka njohur ato si instrumente të domosdoshme për formimin e vullnetit politik të popullit, duke i ngritur ato në rangun e institucioneve të së drejtës kushtetuese. Megjithatë, partitë nuk bëjnë pjesë në organet e larta të shtetit dhe, si të tilla, shteti nuk ka detyrim t'i financojë në mënyrë të vazhdueshme.

¹⁷Neni 19 i ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike".

¹⁸Neni 17 i ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike".

¹⁹Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane 19 korrik 1966.

Partitë politike ndikojnë në formimin e vullnetit politik, duke marrë pjesë në zgjedhje, të cilat pa to nuk do të mund të organizoheshin. Ato janë pra, një ndërmjetësues midis individëve dhe shtetit, nëpërmjet të cilit realizohet zbatimi i vullnetit të shtetasve dhe gjatë periudhës midis zgjedhjeve. Partitë që përbëjnë pakicën formojnë opozitën dhe e bëjnë atë sa më funksionale. Një financim i pjesshëm ose i plotë i partive në mënyrë të përhershme nga mjetet publike nuk pajtohet me parimet e përgjithshme të Kushtetutës sonë. Një financim i pjesshëm mujor ose vjetor nga shteti i partive gjatë gjithë veprimtarisë së tyre, do t'i ngrinte partitë në nivelin e organeve shtetërore. Kështu arrihet në përfundimin se financimi i përhershëm i partive nuk rrjedh nga fryma e Kushtetutës. Partitë politike, duke qenë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e bindjeve, të pikëpamjeve dhe interesave të përbashkëta politike, në aspektin kushtetues dhe ligjor, nuk mund të njësohen me institucionet shtetërore²⁰.

IV. KONTROLLI I FINANCIMEVE TË PARTIVE POLITIKE

Një nga problemet që shtrohet sot është dhe ai i kontrollit të financimeve joshtetërore të partive politike. Kjo çështje ngrihet për diskutim sidomos para dhe gjatë fushatave zgjedhore, ku partitë hyjnë në garë me njëra-tjetrën, në kushte të pabarabarta sa i përket buxhetit që kanë në dispozicion, për të “korrur” votat e zgjedhësve. Kjo nuk është dukuri shqiptare. Ka plot raste, ku në prag zgjedhjesh kanë “plasur” skandale lidhur me financimin e partive politike²¹.

²⁰ V-33/01 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Përmbledhje e vendimeve të GjK 2000-2001, 213.

²¹ Rasti më i fundit është ai i financimit të CDU-së gjermane, ish-Kryetari i së cilës, Helmut Kohl ish- kancelar për 16 vite rresht, u rrethua nga zhurma e skandalit lidhur me financimin nga fonde të errëta të partisë së tij. Gjithsesi, edhe sot ky financim mbetet enigmë, pasi ai nuk pranoi të tregonte burimin e tyre, duke i cilësuar thjesht si donacione të partive mike.

Problemet kushtetuese që paraqet financimi i partive politike rrjedhin nga një vetëpërmbytje e ligjvënësit në përcaktimin e kufijve të informacionit që duhet të japin partitë politike lidhur me të ardhurat që përfitojnë nga rrugë e mjete të ndryshme. Sipas nenit 9/3 të Kushtetutës, partitë politike janë të detyruara të bëjnë publike burimet financiare dhe shpenzimet e tyre. Me këtë dispozitë, Kushtetuta ka vënë shprehimisht nën kontroll financat e partive politike, duke respektuar kështu parimin e transparencës. Kushtetuta nuk shprehet qartë lidhur me pyetjen se si duhet të realizohet financimi i partive politike, por ajo ka dhënë vetëm sigurinë se të gjitha të ardhurat, pavarësisht se në ç' mënyrë janë realizuar, duhet të bëhen publike dhe të deklarohet origjina dhe destinacioni i tyre. Qëllimi i një dispozite të tillë është te sigurimi i informacionit, megjithëse jo aq i detajuar, që duhet të ketë zgjedhësi “mbi forcat ose faktorët që përcaktojnë vijën politike të partisë, si dhe te krijimi i mundësisë për të kontrolluar, nëse përputhet programi i partisë politike me veprimet e atyre që mundohen të ndikojnë me anë të mjeteve financiare në jetën e partive politike”²².

Pavarësisht nga sa parashikohet prej ligjvënësit²³, mund të thuhet se sot ka shumë pak, për të mos thënë aspak, njohuri mes zgjedhësve shqiptarë lidhur me burimin e financimeve të partive politike. Sa i përket kufijve të detyrimit, për të dhënë llogari mbi origjinën e mjeteve financiare, ky rrjedh nga neni 9/3 i Kushtetutës, por përveç faktit që ata detyrohen t'i bëjnë publike të ardhurat, nuk ka mjete shtrënguese për realizimin e këtij detyrimi kushtetues. Në një vendim të saj²⁴, Gjykata Kushtetuese ka arritur në

²² Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane BVerfGE 20, 56, (106).

²³ Neni 21 i ligjit “Për partitë politike” parashikon se ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga qeveri dhe nga ente publike ose private të huaja, si dhe nga ente vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror. Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privatë vendas.

²⁴ V-33/01 i Gjykatës Kushtetuese, Përmbledhje e vendimeve të GjK 2000-2001, fq. 215.

përfundimin se pavarësisht se financat e partive politike nuk mund të kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nuk do të thotë se ato janë të pakontrollueshme. Mosrespektimi i detyrimit për të deklaruar të ardhurat e partive përbën juridiksion kushtetues dhe një nga kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur antikushtetushmërinë e partisë politike. Me anë të këtij interpretimi Gjykata Kushtetuese e konsideroi faktin e financimeve të paligjshme, ose mosdeklarimin e burimeve të tyre, si shkak për antikushtetutshmëri të partisë politike. Gjykata Kushtetuese, po në këtë vendim ka arritur në përfundimin se partitë politike si bashkime vullnetare nuk mund të kontrollohen nga organe shtetërore, duke moslejuar kështu cenimin e lirisë së veprimit politik të tyre, si një nga parimet kryesore të pluralizmit²⁵.

Instrumenti i kontrollit të kushtetushmërisë së partive politike nga Gjykata Kushtetuese paraqitet paksa i vështirë për t'u vënë në lëvizje, pasi një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm Presidentit i Republikës, Kryeministri dhe një e pesta e deputetëve²⁶. Pyetja që nuk gjen një përgjigjet plotë dhe të saktë është: Sa të kontrolluara janë financat e partive politike, duke ditur rolin e tyre në organizimin e shtetit.

Çështja e financimit të partive shihet edhe si problem që shpesh mban mbi vete “parregullsi”, të cilat evidentohen nga veprimet e elitës shtetërore nëpërmjet favoreve që arrijnë të sigurojnë për partitë e tyre edhe kur arka e shtetit është bosh. Hapësira e veprimit, për të ngushtuar sa më shumë që të jetë e mundur këtë praktikë është e vogël, pasi në fund të fundit janë vetë partitë, përfaqësuar në parlament, ato që kanë kompetencë për të vendosur, si bartës të vullnetit të popullit.

²⁵ Gjykata Kushtetuese vendosi në përfundim të shqyrtimit të çështjes shfuqizimin e dispozitës ligjore që shrinte kontrollin e KLSH-së edhe ndaj financimeve të tjera të partive politike që nuk vinin nga buxheti i shtetit.

²⁶ Neni 57 paragrafi i parë i ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese”.

Përballja e demokracisë me mediat

Marie-France DELHOSTE¹

Përktheu: Diana Estrefi

Ky artikull ka meritën e shtrimit të pyetjeve bazë, të tilla si: A e dobëson demokracinë komunikimi i pabarabartë? A e ka përmbysur përmbajtjen e informacionit futja e televizionit komercial? A nuk po zhvillohet komunikimi audiovizual në dëm të mediave të shkruara? Dhe më në fund, si mund të këshillojmë një votë demokratike me këtë inflacion demografik?

E sigurt është që në asnjë vend nuk është realizuar ende “*shteti i popullit, prej popullit dhe për popullin*”², në vend të tij ka vetëm trillime. Mos vallë duhet parë ky si një fakt pa rëndësi apo si shenjë e një vështirësie logjike të lidhur me vetë nocionin e demokracisë? Duket sikur sistemi mazhoritar i votimit, si kyçi i shoqërive demokratike, mbart në vetvete kontradikta të pazgjidhshme. Kështu, në vitin 1951 ekonomisti Kennet Arrow do të përcaktonte një analizë aksiomë të procedurave të votimit. Ai krijoi teorinë e tij të pesë aksiomave që i shndërrojnë preferencat individuale në përzgjedhje kolektive, gjithnjë duke respektuar rregullat demokratike³ duke vërtetuar kështu atë teoremë, sipas së cilës, vetëm sistemet politike të

¹ Doktoreshë e drejtës publike, ATER në Universitetin Monteskjë, Bordo IV.

² Kushtetuta e 4 tetorit 1958, neni 2, Francë

³ *Shih D.Blair, R. Pollak, Logjika e përzgjedhjes kolektive, “Pour la Science”, korrik 1999, Nr. special, f. 82.*

afta për të respektuar këto pesë aksioma janë sistemet që arrijnë të përqëndrojnë tërësinë e pushteteve në duart e një individi të vetëm. Ai do të provonte, përveç kësaj, se duke i shtuar këtyre pesë aksiomave një të gjashtë, duke parashtruar mungesën e diktaturës, nuk mund të ekzistojë asnjë kushtetutë që të respektojë këto gjashtë aksioma. Për këto punime mori çmimin Nobel në ekonomi në vitin 1972. Që nga kjo datë, asnjë kërkues nuk ka mundur të shmangë vendosjen teorike të një diktature. Pra, nuk mund të ekzistojë sistemi ideal, për të përcaktuar një përzgjedhje kolektive demokratike. Megjithatë, çdo shoqëri duhet të bëjë përzgjedhje kolektive dhe të shpikë procedurat e votimit, të cilat që në momentin e krijimit janë me gabime.

Kompromiset e detyrueshme, që duhet të sigurojnë një funksionim sa më harmonik të institucioneve, për fat të keq nuk mund t'i mbulojnë dëmtimet. Në qoftë se është utopike të kërkosh zbatimin e “kushtetutës së përsosur”⁴, do të ishte gjithashtu e padëshirueshme që të largoheshë shumë prej saj. Pikërisht për këtë Pierre Pactet-i kujton se “demokracia nënkupton (...) edhe edukim, edhe informim. Përzgjedhja mund të jetë e qartë kur bëhet fjalë për një qytetar të ndërgjegjshëm, i aftë të krahasojë programet dhe arsyetimet, që ka një nivel kulture dhe që është pak a shumë i informuar nga mjetet e zakonshme të komunikimit. Mirëpo vihet re se këto kushte nuk janë gjithmonë të bashkuara...”⁵

Teknologjia e kudondodhur dhe rritja e popullsisë në shoqëritë moderne sigurisht që e kanë ndryshuar komunikimin. Televizioni e interneti, fryte të shkencës moderne, ndryshojnë krejtësisht nga ai “komunikim njerëzor”, me gojë ose me shkrim, që ekzistonte dikur, në kohën e krijimit të konceptit për demokracinë. Këto media kanë krijuar një komunikim të veçantë, duke e mbyllur njeriun brenda një guacke, me qëllim që të manipulohet lehtë.

⁴ Aristoteli, Politikat.

⁵ P. Pactet, Institutions politiques-Droit constitutionnel, Armand Colin, 2000, botimi i 19-të, f.86.

Duke qenë elementet kyçe të demokracisë, komunikimi dhe informimi e bëjnë atë tepër të ndjeshme. Ndryshimi i shkallës së popullsisë ka përmbysur edhe raportet njerëzore. Çfarë ka të përbashkët mes një qyteti grek dhe një shteti kinez ose indian me mbi një miliard individë?⁶ Meqenëse komunikimi global aty bëhet materialisht i pamundur, shoqëria ndahet në entitete individuale, dhe ky izolim i individit shoqërohet me lindjen e një fenomeni të ri, atij të nënshtrimit të funksionimit të shoqërisë ndaj ligjeve të statistikës. Nga pikëpamja strukturore këto të fundit kanë ende efekte negative mbi evoluimin e praktikës elektorale demokratike.

KUDONDODHJA E MEDIAVE ELEKTRONIKE DHE DEMOKRACIA E CENUAR PREJ TYRE

Televizioni dhe interneti, mediat më zotëruese sot në botë, duhej të përcillnin te të gjithë informacionin dhe kulturën e nevojshme. Këto shpikje kaq universale e me përhapje pak të kushtueshme shpjegojnë atë entuziazëm fillestar të qarqeve intelektuale dhe pushteteve politike ndaj tyre. Përmasat e përhapjes së tyre sot janë aq të mëdha, sa është i pamundur e madje i padëshirueshëm një kthim prapa.

Mirëpo, ashtu si për çdo dukuri që përhapet shpejt, edhe inkuadrimi i tyre ishte i pamjaftueshëm. Autoritetet publike kanë frikë ta pranojnë drejtimin e gabuar që morën këto mjete komunikimi. Ato nuk guxojnë t'u imponojnë një kontroll të rreptë këtyre mjeteve, për shkak të respektimit të lirisë së shprehjes. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, megjithatë, nënvizonte që në vitin 1993 se “mediat duhet të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre ndaj qytetarëve dhe shoqërisë në përgjithësi, sidomos në çastet kur informimi dhe komunikimi kanë një rëndësi të madhe si për zhvillimin e personalitetit të

⁶ Kinë: 1,26583 miliard, regjistrim i v.2000 (Ministria e Punëve të Jashtme); Indi: 1,027 miliardë, regjistrim i v.2001 (ambasada e Indisë në Francë).

⁷ Rezoluta 1003 për etikën e gazetarisë, prot.1.

qytetarëve, ashtu edhe për evoluimin e shoqërisë dhe jetës demokratike”.⁷ Pierre Pactet-i lajmëron, gjithashtu, edhe për rrezikun e një keqinformimi të popullsisë, duke theksuar se “nëse masa është e informuar keq dhe është e paqartë, pushteti mund të ndikojë dhe ta manipulojë më lehtë atë”⁸. Këtu fillon risku i shndërrimit të informacionit dhe i shtrembërimit të kulturës nëpërmjet impaktit të pabarabartë të një popullsi gjithmonë e më tepër të ndjeshme psikologjikisht, nga njëra anë, dhe mbërritjes së mediave komercialisht të manipulueshme, nga ana tjetër.⁹

DEMOKRACIA E NDJESHME NDAJ KOMUNIKIMIT TË PABARABARTË

Në ditët e sotme, në një familje franceze, televizioni ndiqet mesatarisht 5 orë e 45 minuta në ditë.¹⁰ Interneti vizitohet jo vetëm në familje, por edhe në punë, për qëllime vetjake.¹¹ Sidomos të rinjtë e kanë shumë për zemër këtë mjet informimi dhe kënaqësi njëkohësisht. Madje Microsoft-i parashikon se në të ardhmen “të rinjtë do të jenë pothuajse gjithnjë të lidhur në rrjet”.¹² Kështu, individi gjendet i sulmuar nga një sasi mjaft e madhe informacioni të pasistemuar, i paaftë të tërheqë informacionin e dobishëm në këtë lumë që sjellin ekranet. Duke qenë të pabarabartë në zotërimin e teknikave të

⁸ P. Pactet, *Institutions politiques-Droit constitutionnel*, Armand Colin, 2000, botimi i 19-të, f.90.

⁹ Në vitin 1995 KE-ja shprehej kështu: “Jemi gjithnjë e më shumë të rrethuar dhe të ndikuar nga figura: fotografi, kinema, por edhe televizion, video dhe kompjuter. Figura po merr fuqi aq të mëdha, sa ne ndodhemi përballë nocionit të “realitetit virtual”, duke u rrezikuar nga manipulimi i figurave që ilustrojnë aktualitetin dhe dokumentarët. Fuqia e figurës, *raport i Asamblesë Parlamentare të KE-së, maj 1995, prot.1.*

¹⁰ *Le Monde*, 28 maj 2002.

¹¹ Ky përdorim tolerohet nga punëdhënësi kur bëhet “me takt dhe me masë”.

¹² *Perandoria e mediave – Këndvështrim*, botim i *Le Monde Diplomatique, maj-qershor 2002, nr.63, f.6-96, shih veç. P. Breton*, Kulti i Internetit, f.20 e vazhdim.

informimit, njerëzit bëhen të pabarabartë edhe në marrjen dhe analizën e informacioneve, aq sa edhe vetë demokracia bëhet shumë e ndjeshme që në çastin e transmetimit të këtyre informacioneve.

Disa shtresa të popullsisë janë të paafta të miradministrojnë këtë lumë informacioni që marrin. Raporti i Komisionit Hetimor për kriminalitetin te të miturit e tregon me terma të qarta ndikimin e televizionit te të rinjtë. Ai vëren se “te të rinjtë e fëmijët ndjekja e televizionit zë shumë orë në ditë dhe, ndryshe nga ç’duket, vetë televizionet, si edhe mediat e tjera, kanë nevojë për edukim, mungesa e të cilit i bën fëmijët të ndikohen lehtë nga figura që i dëmtojnë rëndë ata.”¹³ Si të mos njohësh atëherë edhe fatin e pabarabartë të fëmijëve që ndjekin mediat, sipas mjedisit të tyre familjar? Prindërit me kulturë të pakët, që janë të detyruar të lëvizin për të gjetur punë, familjet e shkatërruara prej papunësisë nuk kanë as kohë dhe as aftësi intelektuale ose mundësi psikologjike për të siguruar edukimin e nevojshëm për ta. Nuk mund të fshihen edhe vështirësitë e hasura nga nxënës, prindër ose mësues në zona socialgjeografike të veçanta. Kështu, që nga viti 1999, të paktën 1 në 5 nxënës ndodhet në zona me edukim përparësor, dhe pothuaj 1 milion e 700 mijë janë të ndarë në 900 zona të tjera... Lind pyetja se si do të mundin ata të bëjnë një përzgjedhje të informacionit, kur nuk janë të aftë të kuptojnë përmbajtjen e tij? Kur të jenë të rritur, a do të dinë të analizojnë informacionin për të vendosur në pavarësi të plotë përzgjedhjen e tyre qytetare?

Nëse sasia e informacionit është një burim potencial rreziku, cilësia e tij është rrezik në atë masë sa është bërë një kërcënim real për demokracinë. Në fakt, tashmë është pranuar se “shumica e njerëzve nuk dinë “të lexojnë” figurën, çka mund të çojë në interpretime shumë të gabuara dhe në manipulime”¹⁴. Jemi të detyruar të pranojmë se universi që krijohet në

¹³ Raporti i komisionit hetimor për kriminalitetin te të miturit, Senat nr.340, qershor 2002.

¹⁴ *Pushteti i figurës, raport i Asamblesë parlamentare të KE-së, maj 1995, prot 3.*

ndërgjegjen e të rinjve, të cilët në fëmijërinë e tyre pësojnë një lloj ndikimi, ndriçohet nga disa figura që i bëjnë ata të ëndërrojnë, ashtu siç shihet një ëndërr. Prandaj dhe ndriçimi psikologjik ka rëndësi të madhe përsa i përket ekuilibrit moral të fëmijës.¹⁵

Mendjet e reja, të modeluara në këtë mënyrë, kur rriten bëhen “gjah” i pambrojtur prej televizionit aq bindës e të fuqishëm ose prej anarkisë së internetit. Po të analizosh përmbajtjen e informacionit që merret në internet, vihet re një mosrespektim i plotë i vlerave demokratike. Asnjë ligj aktual nuk mund ta pengojë realisht dërgimin nëpërmjet internetit të çfarëdolloj mesazhi. Në kundërshtim me çdo ligj, mbretëron liria absolute. Nuk mbrohen fëmijët, të cilët nën një fjalë të bukur mund të gjejnë site pornografike ose të dhunshme. Shpeshherë dërguesi i mesazhit apo i sitit nuk identifikohet ose mund të jetë nga një vend krejt i huaj.¹⁶ Kështu që rrallëherë ka ndëshkime dhe ata që ndëshkohen janë “më të ngathtit”.¹⁷ L. Moreillon vëren “se zgjidhjet që jep legjislacioni për internetin janë të kufizuara. E drejta kombëtare s’ka ditur t’i përshtatet zhvillimeve të infrastrukturës, duke mbetur shpeshherë e pafuqishme ndaj saj”.¹⁸ Çdo gjë mund të kalojë nëpër Internet, përfshirë edhe informacionet më të rrezikshme. Por ata që kanë aftësi dhe kulturë dinë të zgjedhin mes shumë të dhënave, duke e ndarë kështu grurin nga egjra.

Instrumenti i demokratizimit universal të dijes bëhet një mjet i fuqishëm pabarazie. Të rriturit në vështirësi bëhen një shenjestër mjaft e lehtë për t’u

¹⁵ JCP 1961, II, nr.12097, vëzhgues H. Delpuch.

¹⁶ Si mund të mendosh se nën emrin “Pesha dhe shtangat” fëmijët do të gjejnë site pornografike? A është normale që fëmija të gjejë figura të tilla duke kërkuar për peshëngritjen?

¹⁷ Mbi legjislacionin dhe jurisprudencën lidhur me këtë çështje, J. Francillon, Shkelje të së drejtës për informim e komunikim, *Rev. sc. crim.*2000,Of.639; L. Moreillon, Shtypja e ciberpornografisë në të drejtën zvicerane, franceze, gjermane e angleze, *Droit de l’informatique et des télécoms*, 1997/3, f.15.

¹⁸ Po aty.

arritur prej figurave që shpërndahen. Në një raport të kohëve të fundit të OBSH-së tregohet se “25 për qind e individëve shfaqin 1 ose disa turbullime mendore gjatë jetës së tyre”.¹⁹ Prandaj cilësia e informacionit do të ishte një element i rëndësishëm në respektimin e formimit të opinionit të këtyre të rriturve kaq të ndjeshëm.

Kategoria e fundit e njerëzve që përjashtohen nga kjo pjesë e botës së informacionit janë të moshuarit. Ata, për arsye të moshës, jo vetëm që nuk kanë njohuritë e duhura, por as edhe mundësitë për t’u përshtatur me mjetet e reja të komunikimit. Duhet nënvizuar, përveç kësaj, edhe ekzistenca e një diskutimi të vërtetë, i cili përjashton të moshuarit nga teknologjitë e reja të informimit, duke iu dedikuar vetëm të rinjve, mbi të cilët mbështeten”.²⁰

Përveç këtyre, përjashtimi i disa shtresave sociale prej komunikimit të vërtetë, duke dobësuar kështu demokracinë, ndodh edhe për shkak të lindjes së televizioneve komerciale.

DEMOKRACIA E KËRCËNUAR NGA MANIPULIMI I INFORMACIONIT

Futja e televizionit komercial e ka çoroditur përmbajtjen e mesazheve që ai transmeton. H. Pigeat-i e denoncon braktisjen e cilësisë së informacionit në përfitim të “shkarkimit të adrenalinës, (...) nga ku vijnë tentativat për shok, sensacion, dhunë,²¹ sepse televizioni, ashtu si edhe gazetatat, shet hapërsirat publicitare ose më ekzaktësisht shet publikun që e ndjek. (...) dhe,

¹⁹ *Rapport sur la santé dans le monde, 2001, f.23.* Ky raport, mes të tjerësh sqaron se turbullimet depresive “në moshat 15-44 janë shkaku i dytë i sëmundjeve që prekin njerëzit”.

²⁰ Perandoria e mediave, *Manière de voir, bot. Le Monde Diplomatique, maj-qershor 2002, nr.63, f.6-96, shi veç. P. Breton, f.21.*

²¹ *Qëndrimi i Asamblesë së KE në vitin 1995 ishte i prerë: “shoqëritë televizive kanë prirjen të konkurrojnë nëpërmjet dramave dhe horrorit. Por deri kur figurat do vazhdojnë të jenë spektakolare? A mund të parashikohet një mungesë e plotë limiti?”* Fuqia e figurës, raport i cituar më lart, f.13. *Karl Poper shpjegon nga ana e tij: “Ka një vështirësi të madhe,*

duke qenë më i madh në numër se publiku i gazetave, vetë sfidat komerciale janë akoma më të mëdha dhe më të ashpra”.²²

Rezoluta e 1003-të e Asamblesë së Këshillit të Europës pohoi në vitin 1993 se “lajmet duhet të përhapen duke respektuar parimin e vërtetësisë dhe duhet të shpalosen, të përshkruhen ose të paraqiten me paanshmëri”.²³ Mirëpo vihet re që niveli kulturor i televizioneve nuk ka rreshtur së uluri rregullisht. Rezulton një pabarazi njohurish mes qytetarëve të ndryshëm, ku më të kulturuarit kanë akses në kulturë dhe informacion në të gjitha kuptimet dhe ku më pak të favorizuarit i kalojnë orët duke parë lojërat televizive, sport, spektakle, filma pornografikë ose me dhunë, duke përshkuar kështu aspektet më të vajtueshme të kulturës amerikane ose të tele-realitetit.²⁴

Premtimi se demokracia audiovizive do të bazohet mbi informacionin e trajtuar jo si mall, por si e drejtë themelore,²⁵ duket se nuk është mbajtur.

të brendshme që është shkaku i degradimit të televizionit. Niveli i tij është ulur sepse hallkat, që duhet të mbanin lidhur shikuesit u ndjenë të detyruara të prodhonin gjithmonë e më shumë emisione sensacionale dhe ajo që është sensacion rrallëherë është e mirë. Televizioni: një rrezik për demokracinë, Anatolia, 1994, kol. 10/18, f.21.

²² H. Pigeat, *Mediat dhe deontologjia, rregulla të lojës apo lojë pa rregulla*, PUF, 1997, f.145. Në rekomandimin 1215 (1993) e Asamblesë Parlamentare të KE-së për etikën në gazetari, është saktësuar se “nuk mund të mos njihet që, meqë mediat janë ndërmarrje që kërkojnë rritjen e numrit të shikuesve e dëgjuesve, dmth të marrësve, ndër objektivat e tjerë kanë edhe rritjen e hapësirave publicitare për të siguruar financimet e veta”. (shih prot.14)

²³ Rezoluta për etikën në gazetari, i sipërcituar, prot.4.

²⁴ I.Ramonet vëren se ndjenja “e fuqisë..., e dominimit..., ende e theksuar për shkak se personazhet kanë në përgjithësi një psikologji elementare, i bën shikuesit të lidhen me heronjtë e serive. Dhe pa dyshim shpjegon atë mrekullim para skenave të thjeshta, boshe, banale, me dialogje dhe situata pa kuptim...Suksesi i të neveritshmes në televizion ka rritur shumë shijen për forma edhe më të ndyra, ...Pas publicitetit dhe propagandës politike, pornografia dhe mbidhuna i kanë hapur rrugën pajtimit me të turpshmen” *Perandoria e mediave, Mënyra e të shikuararit bot. Le Monde Diplomatique, maj-qershor 2002, nr .63f.6-96, shih veç. I.Ramonet, Big Brother, f. 30 e vazhdim.*

²⁵ *Asambleja Parlamentare e KE-së, rezoluta 1003 (1993), për etikën në gazetari, prot.15.*

Atëherë shtrohet pyetja mjaft shqetësuese se a mund të mbijetojë demokracia nëse kultura i është dorëzuar plotësisht tregut?²⁶

Në fakt, manipulimi i mediave për qëllime tregu, si pasojë e fuqizimit të televizioneve komerciale, është një rrezik që po e shkatërron demokracinë. Ashtu siç saktëson edhe *Le Monde Diplomatique*: “të zbutësh, të shtrosh dhe të nënshtrosh, këto janë objektivat (e vjetra) që kishin mediat e mëdha në çastin e revolucionit të teknologjive të reja. Mënyrat më të frytshme të manipulimit kërkojnë të nënshtrojnë në shoqëritë demokratike çdo shpirt kritik, çdo mendim për protestë ose ëndërr për revoltë. Sistemi mediatik transformohet në një aparat të vërtetë ideologjik të mondializimit liberal”.²⁷ Shpërthimi i publicitetit²⁸ veçanërisht ka pasur si rrjedhojë një transformim të tillë: televizioni nga informues është shndërruar në manipulues.²⁹ Si mund ta imagjinosh që shifrat e industrisë publicitare të rriteshin, kur veprimi i saj do të ishte i frytshëm?³⁰ Mirëpo të nxisësh një individ të konsumojë, do të thotë të ndikosh në zgjedhjet e tij vetjake dhe politike. Ai orientohet drejt

²⁶ Perandoria e mediave, *shih veç. J.Rifkin, Erdhi koha e rrjeteve, f.10 e vazhdim.*

²⁷ Po aty, Nënshtimi i mendjeve, kap.2, *Manière de voir, Le Monde Diplomatique, maj-qershor, 2002, nr.63,f.29.*

²⁸ “Është përcaktuar se aktualisht në vendet e zhvilluara, gjuajtjet publicitare kanë më shumë se 2500 impakte për person në ditë. Televizioni francez, ka dhënë në v. 1999 më se 500000 spote”, Perandoria e mediave, i cituar, veç. I.Ramonet, Fabrika e dëshirave, f.36 e vazhdim.

²⁹ “*Shekullii XX, me rritjen e mediave elektrike (radio, kinema), elektronike (televizioni) dhe numerike (Interneti), ka parë jo vetëm shpërthimin e publicitetit, por edhe sofistikimin e tij. Ambicja për të manipuluar shpërthim u rrit pothuajse në nivelin e një shkence. Teknikët e bindjes përdorën metodat më të holla për të depërtuar në shpirtin tonë, duke kapërcyer barrierat e duke shkatërruar mosbesimin ndaj tyre*”. I. Ramonet, po aty.

³⁰ “*Mes viteve 1950-1996 shpenzimet publicitare botërore janë shumëfishuar shtatë herë(...). Në Europë shpenzimet për spote publicitare duhet të kenë kaluar nga 27.8 miliard dollarë në v. 1996 në 40.6 miliard dollarë në 2004*”. Perandoria e mediave, D. Schiller, Parazitët e përditshëm, f. 78 e vazhdim.

shoqërisë së konsumit, begatisë, pra materialistes, në kurriz të shoqërisë që ngre vlerat shpirtërore. Etja për konsum rritet, ai pranon sipërfaqësoren, shkurtimin e jetëgjatësisë, duke zbatuar këtë sistem nga të gjitha mundësitë e zgjedhjeve të tij vetjake.³¹ Atëherë, përfundimi është zhdukja e demokracisë humaniste. Publiciteti nuk është e vetmja formë e manipulimit të shpirtit. Televizionet komerciale tentojnë të imponojnë edhe zgjedhjet ideologjike të aksionerëve e të grupeve të mëdha të komunikimit. Nëpërmjet valëve, propozimi ekonomik bëhet uniform në të gjitha mediat, duke krijuar idenë se ekonomia do të ishte një botë më vete e qeverisur nga privatët e fuqishëm, të cilët shtetet nuk do të mund të kenë të drejtë t'i kontrollojnë dhe ne duhet t'i heqim vizë vullnetit politik dhe progresit social.³²

Përveç kësaj, kronikat ekonomike janë të përditshme, ndërsa përcjellja e treguesve të bursës pothuajse e përhershme.³³ Nuk mund të mos dyshosh kështu për rëndësinë kryesore që ekonomia dhe ndërmarrja e saj “mirëbërëse dhe e nevojshme” kanë në të gjithë botën. Pranohet, pra, se ajo e vë politikën “nën tutelë” dhe jo e kundërta, siç do të duhej të ndodhte. Por a mund të flasim ende për demokraci, kur qytetari është i mbytur në mesazhe të njëjta,

³¹ *Ideologjia, e për rrjedhojë publiciteti i grupeve të mëdha ekonomike ka evoluar shumë gjatë dekadave të fundit. Mund të lexoje në v. 1967 në revistën Një pronar i pararojës: Paul Ricard, “Mungesa e idealit vjen nga moskuptimi i plotë, diktuar nga lakmia e disave dhe mjerimi i të tjerëve(...) Te ne, proletariati zhduket, duke ia lënë vendin punëtorëve të pasur. Sepse, ashtu si një injorant nuk mund të jetë një njeri i lirë, nuk mund të ekzistojë liria e vërtetë pa pronën private(...) Ne e dimë që nuk mund të ketë rritje të kushteve njerëzore pa këtë pavarësi të individit, i cili i jep njeriut dinjitetin e vet, si në planin material, ashtu edhe në atë shpirtëror” Galaxie 1967, nr.38, f.157. Në të kundërt, ideologjia e udhëheqësve ekonomikë aktualë - që shfaqet në publicitet - duket se është zbratur nga çdo lloj humanizmi. Nuk ka më aty respekt për njeriun, dëshirë për rritje morali ose për progres social.*

³² Perandoria e mediave, shih veç. S. Halimi, *Dhimbjet kronike ekonomike, f.84 e vazhdim.*

³³ *Vërehet se “të qenit e bursës njëherësh në shumë vende, përfundon duke u dhënë disa kuotimeve me vlerë rol qendror për jetën tonë ... Dhe kjo, atëherë, kur në Francë aksionerët janë vetëm 13.4 për qind e të rriturve...” S. Halimi, po aty.*

të cilat i shpjegojnë se ai nuk ka aspak fuqi të marrë vendime ose të orientohet në ekonomi, ose të paktën të përfaqësohet?³⁴

Në qoftë se rreziku është i madh për demokracinë kur mediat manipulohen për qëllime komerciale, e njëjta gjë ndodh edhe kur qëllimet janë politike. Kështu, gazeta *Le Monde* ka denoncuar paraqitjen e kriminalitetit në televizion gjatë fushatës së fundit zgjedhore, duke theksuar se ai është paraqitur “në media 126 për qind më shumë mes shkurtit dhe marsit 2000, duke u ulur në 50 për qind pas turit të parë të zgjedhjeve presidenciale (...). Televizioni ka kontribuar më shumë se 60 për qind në këtë zhvillim”.³⁵ I njëjti grup shtypi vërejti se “me gjithë thirrjet e përsëritura për etikë, mediat në masë po hyjnë në epokën e re të gënjeshtërisë. Mashtrimet dhe gënjeshttrat po ndjekin njëra-tjetrën, sidomos në raste debati. Përpjekjet për bindje, nëpërmjet sharjeve falso, shtohen dhe shembuj të tillë gëlojnë nëpër mediat e rrëmbyera nga urrejtja dhe të nxitura për të helmuar mendjet e njerëzve”.³⁶ Ky konfuzion, nga i cili përfitojnë mediat “në përgjithësi të pandërgjegjshme, mes asaj që shohin e njohin, ose që shohin e kuptojnë, përdoret nga televizioni për manipulime. Në diktaturë përdoret censura, në demokraci, manipulimi”.³⁷

Në vitin 1994 Karl Popper-i bënte një paralajmërim: “Televizioni ka fituar një pushtet mjaft të madh në gjirin e demokracisë. Asnjë demokraci

³⁴ Vërehet se nevoja për diversitet në media nuk është respektuar. Pranohet, gjithashtu, se “pluralizmi është sot parimi themelor i të drejtës së medias. Pluralizmi mbështetet mbi diversitet dhe pluralitet opinionesh në çfarëdolloj fushe qoftë (...) Pluralizmi është garancia e demokracisë së vërtetë”, E drejta e mediave, nën drejtimin e C. Debbash, Dalloz, 1999, f.2-3.

³⁵ *Le Monde*, 28 maj 2002.

³⁶ Perandoria e mediave, Intoksikim dhe gënjeshttra, kap.3 *Manière de voir*, bot. *Le Monde Diplomatique*, maj-qershor, 2002, nr.63, f.49.

³⁷ R. Kapuscinski, A reflektojnë mediat realitetin në botë? *Manière de voir*, bot. *Le Monde Diplomatique*, maj-qershor, 2002, nr.63, f.54.

nuk mund të mbijetojë nëse nuk i jep fund këtij pushteti”.³⁸ Sot ky paralajmërim mund të bëhet për internetin. Ndikimi tepër i madh e mediave ekziston vetëm sepse mungon komunikimi efektiv mes qytetarëve të lidhur në një numër të madh individësh, të cilët përbëjnë trupën sociale. Kjo mungesë komunikimi ndërhyr pastaj në elementin thelbësor të demokracisë, në votën e qytetarëve.

PAMUNDËSIA PËR VOTIM DEMOKRATIK LIDHET ME INFLACIONIN DEMOGRAFIK

Komunikimi pjesërisht është i lidhur me demografinë. Në shoqëritë primitive komunikimi bëhej me gojë. Ai ishte efektiv sepse numri i individëve ishte relativisht i vogël. Në qytetërimin grek ekzistonte komunikimi me gojë dhe me shkrim. Meqë numri i popullsisë ishte i kufizuar, ai gjithashtu ishte efektiv.

Në shoqëritë tona moderne komunikimi është bërë plotësisht pavetor. Nuk qarkullojnë më informacione nga individi tek individi, përveçse në qarqe shumë të ngushta. Kështu, komunikimi vepron në dy modele: njëri në shkallë njerëzore, dhe është gjeografikisht ose shpirtërisht i kufizuar, dhe tjetri në shkallë shoqërie, pavetor dhe me një drejtim të vetëm. Individi nuk mund të marrë pjesë në komunikim, ai s’është gjë tjetër veçse një marrës pasiv.

Meqë komunikimi qëndron në themel të demokracisë, kuptohet që kjo shkëputje në kontaktet njerëzore çon në shtrembërim të ushtrimit të të drejtave të qytetarit në zgjedhjen e përfaqësuesve të vet. Në vendet moderne, struktura e komunikimit, e cila nxitet nga demografia, duket se është një pengesë për efektivitetin e funksionimit të demokracisë. Përveç kësaj, ky komunikim me dy nivele, për vetë natyrën e tij, sjell një çoroditje të pandreqshme të votës popullore.

³⁸ Karl Popper, Televizioni: rrezik për demokracinë, *cit. më lart, f.36.*

EFEKTET E DEMOGRAFISË MBI KOMUNIKIMIN NË DEMOKRACI

Komunikimi bëhet mes një qytetari të një celule, me një numër të kufizuar njerëzish së cilës ai i përket, nga njëra anë dhe pjesës tjetër të kombit nga ana tjetër. Raportet sociale, dhe komunikimi si pjesë e tyre, shprehen në shkallë individuale. Informacione shkëmbehen brenda një numri të caktuar celulash specifike me përmasa të kufizuara, si p.sh. familjet, mjediset e edukimit, të punës ose të argëtimit. Në secilën celulë individi është njëkohësisht dhënës dhe marrës informacioni, pasi komunikimi asnjëherë nuk është asnjans, por ka efektin e *feedback*-ut. Me zhvillimin e komunikimit individi bëhet më i ndërgjegjshëm për natyrën e saktë të mendimit të tij, konfirmohet më tej ose ndryshohet në marrëdhëniet ndërvetjake që krijohen brenda grupit. Kështu vazhdon komunikimi mes individëve të çdo celule, i cili forcohet në nivel celule, por dobësohet pambarimisht ndërmjet celulave, derisa më në fund nuk mbetet asgjë mes individit dhe pjesës tjetër të popullsisë. Merret me mend, pra, se informimi ndërqytetar mund të ekzistojë vetëm nëse numri i celulave është relativisht i kufizuar, domethënë popullsia është e vogël. Si rrjedhim, demokracia mund të jetë efektive vetëm në shoqëritë me përmasa të vogla. Kjo ishte njëra anë. Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se kombet moderne përbëhen nga një numër i konsiderueshëm individësh. Komunikimi global ndërmjet celulave bëhet materialisht i pamundur. Ai funksionon vetëm në një drejtim: informacionet nisen prej një organi qendror, që është shprehje e një grupi të ngushtë individësh të mbledhur aty për qëllime me interes ekonomik, drejt individit marrës, pasiv. Komunikimi ndërmjet individëve zhduket. Nga kjo pikëpamje duhet vënë re se ekziston jo vetëm frika, por dhe një mospranim absolut i përfaqësuesve, madje edhe i marrëdhënies më të vogël mes qytetarëve me ndërmjetësinë e medias qendrore. Kështu ka ndodhur të mbyllen radiot e lira³⁹ ose televizionet interaktive.

³⁹ Ato ishin pothuajse 400 në shtator 1981. *Shih (grup autorësh) në: Droit des médias (E drejta e mediave), nën drejtimin e C. Debbash, Dalloz, 1999, bot. 26, f.59.*

Pasi e kanë pritur keq këtë mospranim të vazhdueshëm nga politikanët, qytetarët kanë krijuar pavarësinë e tyre falë internetit. Ata po e përdorin këtë mjet për t'u bërë, më në fund, pronarë të komunikimit. Por kjo përpjekje e tyre është e destinuar të dështojë, sepse duhen shumë gjëra që të mund të vendoset një komunikim i lirë mes qytetërve të një vendi të lirë. Fillimisht, aksesit në internet nuk është i mundur për të gjithë ose, më thjesht, ai s'është i përdorshëm nga të gjithë individët. E dyta, grupe të ndryshme e kanë në dorë atë, duke manipuluar kështu opinionin. Së fundi, çdo individ ka një kohë të kufizuar në ditë për të komunikuar. Përpjekjet për komunikim global mes qytetarëve duken, pra, utopike. Në një vend me popullsi shumë të madhe nuk ekziston komunikimi i vërtetë. Përveç kësaj, numri i lartë i individëve që përbëjnë shoqërinë ka shkaktuar pasoja negative të brendshme, të tilla si ato që ka pësuar niveli i komunikimit për realizimin me efektivitet të votimit demokratik.

EFEKTET E DEMOGRAFISË NË ECURINË E VOTIMIT DEMOKRATIK

Që prej disa dekadash zgjedhjet kanë treguar rëndësinë që ka komunikimi në aktin zgjedhor. Mirëpo, duke qenë se një komunikim real është shumë i vështirë në një komb modern, del se edhe akti zgjedhor është i njollosur me një ves strukturor. Në të drejtën kushtetuese pranohet se “në shtetet me përmasa të mëdha fizike, është e pamundur të takosh demokracinë...është materialisht e pamundur., që vërtet pushteti të ushtrohet nga populli”.⁴⁰ Krejt natyrshëm po orientohemi drejt demokracisë përfaqësuese, por, megjithatë, kur ka pasur raste abuzimesh në zgjidhjen e problemeve që kanë nxjerrë institucionet e ndryshme, i jemi drejtuar referendumit. Kështu, duket sheshit se vullneti i popullit mund të shprehet vetëm nëpërmjet votës, e cila, në shoqërinë tonë është një këshillues me të vërtetë demokratik.

⁴⁰ G.Burdeau, F. Hamon, M.Troper, Droit constitutionnel (E drejta kushtetuese), LDGJ, 1999, bot.26, f.84.

Numri i madh i individëve e pengon komunikimin global në shkallë kombëtare. Ka rezultuar se një numër individësh, përafërsisht jo i vogël, mund të asimilohen nga individë krejtësisht të izoluar. Kështu, nga njëra anë vlera e numrit të individëve në marrëdhënie me një individ të dhënë, në raport me totalin e qytetarëve, është pothuajse zero dhe, nga ana tjetër, popullsia është shumë e madhe. Pra, mund të konsiderohet legjitimisht se vota qytetare administrohet tashmë jo më nga ligjet njerëzore, por nga ligjet statistike. Shërbimet e shtetit e kanë përdorur gjerësisht këtë model statistik të shoqërisë dhe, atëherë, edhe shkencëtarët kanë zbatuar në procedurat e votimit ato ligje që kanë të bëjnë me numrat e mëdhenj.

Kështu, S. Galam-i⁴¹ i ka studiuar të dyja aspektet e këshillimit qytetar: zgjedhjen e deputetëve dhe referendumin. Fillimisht ai ka vërejtur se votimi i ligjeve në një asamble të zgjedhur me sistem mazhoritar rezulton me zgjedhje të bëra me nivele të njëpasnjëshme. Në fakt, përcaktohet një listë e kandidatëve të partisë, pastaj zgjedhja e deputetëve sipas zonave zgjedhore e me dy raunde dhe më në fund asambleja (parlamenti) e zgjedhur voton projektligjin. Hipoteza e nisjes është relativisht e thjeshtë dhe konsiston në pranimin e faktit se, në raste të barazisë në votim, situata e mëparshme bëhet e pranishme. E gjithë kjo bazohet në një realitet psikologjik të thjeshtë, në frikën nga “ndryshimi ose moszgjedhja”, marifet i cili, edhe pse i lehtë, është gjithmonë në favor të pushtetit në fuqi dhe i mjaftueshëm për të ndryshuar rrjedhën e votimit, me qëllim që t’i arrihet vendimit përfundimtar. Autori thekson se “edhe pse me pamje të butë, ky marifet ia heq karakterin demokratik procesit zgjedhor”.⁴² Sipas modelimeve matematikore dhe

⁴¹ S. Galam-i është kërkues në laboratorin e mjedisëve të çrregullta dhe heterogjene, i asociuar pranë CNRS-së dhe në Universitetin Pierre e Mari Kyri. Një pjesë e kërkimeve të tij ka të bëjë me përshkrimin e qëndrimeve sociale.

⁴² S. Galam, Votimi mazhoritar, mund të jetë totalitar?, *Les mathématiques sociales, Pour la science, korrik 1999, nr.special, f.90.*

trajtimeve informatike vërehet se grupi i minorancës mund të qëndrojë në pushtet ose një ligj mund të votohet, sepse llogaritet vetëm numri i niveleve të përfaqësimeve në mënyrë të pandërprerë. Pragu kritik që mat vendimin përfundimtar varet vetëm nga ky numër nivelesh. Dhe kështu mund të kemi një vendim të kundërt me atë të shumicës qytetare, edhe pse në fillim mund të ketë pasur 54 deri 77 për qind kundërshtarë të projektit ose të partisë. Ky studiues vëren, gjithashtu, se fare pranë pikës kritike të matjes “edhe një rritje e vogël (2-3 për qind) e proporcionit të votave në favor të opozitës ka për pasojë një ngjitje të menjëhershme të kësaj opozite”.⁴³ Po ashtu, përllogaritjet e tij provojnë se shtimi i numrit të partive e zgjeron këtë efekt të pragut. Gjatë zgjedhjeve të fundit në Francë ai ka vërejtur se me të majtën e bashkuar, pragu i Frontit Kombëtar ishte rreth 30 për qind. Si rrjedhim, edhe me 25 për qind të votave, kjo parti nuk mund të kishte asnjë deputet. Në të kundërt, nëse e majta do ishte e ndarë, pragu kritik zgjedhor do ulej në 22 për qind. Kështu, rrotull kësaj përqindjeje do të mjaftonin vetëm një ose dy për qind të votave shtesë, që duke mos pasur deri atëherë asnjë deputet, kjo parti të merrte përnjëherë shumicën absolute në Asamble. Atëherë, në këto kushte, si mund të bëhet fjalë për demokraci?

Po ky kërkues, për të studiuar këshillimin referendar⁴⁴ e ka ndarë Francën në disa celula të vogla që kanë të bëjnë me çdo individ. Sipas teorisë së tij, këto celula kanë kontakte të kufizuara me disa individë dhe kjo vlen për çdo anëtar të celulës. Dredhia e votës mbetet e njëjta në rast të barazisë së opinionëve që jepen në diskutimet brenda çdo celule dhe midis vetë celulave. Frika nga ndryshimi imponon vazhdimësinë e situatës së mëparshme. Sipas llogaritjeve matematikore dalin rezultate të habitshme. Kështu, nëse një projekt vërtet i ri është pranuar nga 70 për qind e individëve, në votimin përfundimtar ai rrëzohet. Sepse, sipas po këtyre llogaritjeve do të duheshin

⁴³ Po aty.

⁴⁴ S. Galam, A janë të pamundura reformat?, *Le Monde*, 28 Mars 2000.

rreth 80 për qind e opinioneve në favor të tij, që ai të fitonte pastaj në votim. Shndërrimi nga një numër i madh individësh të një kombi, në një numër individësh me qëndrim statistikor, shtrembëron edhe mundësinë e votimit demokratik. Studime të tjera i kanë përforcuar këto rezultate,⁴⁵ të cilat duket se përshtaten shumë me rezultatet zgjedhore. S. Galam-i e ka zbatuar teorinë e tij edhe në referendumin mbi Traktatin e Mastroiitit, ku vërejtë se, nëse në fillim të muajit qershor sondazhet parashikonin 70 për qind “po”, “jo”-ja kishte avancuar rregullisht gjatë muajve në vazhdim, duke arritur në 49 për qind të votimit të bërë në muajin shtator. Sociofizikani tregon mundësinë e “jo”-së në rastet kur fushata zgjat disa javë. A nuk është shqetësues fakti që rezultati të varet nga një datë? Evoluimi i qëllimeve të votimit është, pa dyshim, i lidhur me mungesën e komunikimit real brenda atij kombëtar, prandaj këto qëllime do të kenë zhvillim tepër të ngadaltë.

Shumëllojshmëria e mënyrës së votimit në të gjithë botën dhe në tërë historinë e saj tregon fare mirë vështirësinë për të gjetur një kompromis të pranueshëm për procedurat e votimit. Në Francë mënyrat e këshillimit dhe përfaqësimit popullor janë të ndryshme. Në shkallë kombëtare, që nga zgjedhjet presidenciale tek ato legjislative dhe të senatit, votimet kanë struktura krejtësisht të ndryshme. Mund të përmendim këtu braktisjen e tipit të zgjedhjeve për në Asamblenë Kombëtare, që dukej se ishin më demokratiket, të tipit proporcional dhe që ishin vendosur me Republikën e Katërt, por që më tej u ndryshuan. Kështu që asnjë sistem zgjedhor nuk ka dhënë kënaqësi të plotë ose nuk është vendosur në mënyre universale dhe përfundimtare. Mund ta mbyllim, duke njohur faktin se votimi realisht demokratik është i pamundur.

⁴⁵ D. Stauffer, Percolation and Galam theory of minority opinion spreading; S. Galam, Minority opinion spreading in random geometry; S. Galam, S.S. Wocnsak Dictatorship from majority rule voting, *The European physical journal B* 18, f.183-186 (2000). Shih edhe: Kur reformat demokratike ngecin te ligjet e fizikës, *Science et vie, qershor 2002, nr.1017, f.92.*

Mos vallë demokracia është një utopi... “e lejuar vetëm për qytetet e thjeshta e të vogla (por) e ndaluar për kombet e pasur, që lindën pas revolucionit të tregut”⁴⁶ Kombet moderne nuk kanë përmasa njerëzore; çfarëdolloj komunikimi, në mos real të paktën i kënaqshëm, aty është bërë i pamundur. Empatia⁴⁷, kjo njohje e veçantë e “unit social”, e domosdoshme në demokracinë e vërtetë, nuk mund të ekzistojë. Në shoqërinë franceze, shumë të madhe për njeriun, qytetarët statistikisht janë “francez i mesëm”, individ teorik pa asnjë përfaqësim fizik. Kjo “demokraci moderne e statistikave”, pas zgjedhjeve befasuese, pjell më vonë përbindësia legjislativë. Numri i teksteve mbi ligjet bëhet tepër i madh, çdo tekst më i plotë dhe më kompleks për “të këshilluar të pakëshillueshmin”, pra për të kënaqur këtë “qytetar të mesëm”, domethënë nga pak të gjithë qytetarët njëherësh. A nuk nënkupton realizimi i idealit demokratik rivendosjen e njeriut në vendin që i takon në këtë grupim në shkallë njerëzore?

PËRMBLEDHJE

Demokracia gjendet e kërcënuar nga zhvillimet moderne të shoqërisë. E drejta për komunikim dhe informim po përpiqet të sigurohet në mënyrë të pabarabartë. Shprehja e vullnetit të qytetarëve duket e shtreburuar nga manipulimet mediatike të popullsisë. Përveç kësaj, dukuria e inflacionit demografik po tregon se funksionimi i demokracive po drejtohet nga ligjet e statistikave. Për t’iu përgjigjur këtyre kërcënimeve duhet që demokracia të rishikohet për t’iu referuar pa dyshim asaj qytetarie me nivel me të vërtetë njerëzor.

⁴⁶ O.Duhamel, Y. Mény, Dictionnaire constitutionnel, 1992, f.284.

⁴⁷ Ky nocion mund të kuptohet si aftësia për të parë veten me sytë e të tjerëve, për të parë të tjerët me sytë e të tjerëve dhe të dallos të tjerët me sytë e tyre. Kjo mund të shmangë një demokraci konfliktuale dhe të çojë në një demokraci altruiste, pra, t’i afrohet një “kushtetute të përkryer”.

Analizë kritike e legjislacionit dhe e praktikës shqiptare në vështrim të Kodit të Punës

*Elta Milori
Këshilltare ligjore në
Gjykatën e Lartë*

Shqipëria kaloi një periudhë tranzicioni, atë të transformimit të saj nga një diktaturë me një ekonomi të centralizuar, në një vend demokratik që mbështetet në ekonominë e tregut të lirë.

Gjatë këtyre viteve u realizua edhe ndryshimi i legjislacionit, me qëllim që ai t'i hapte rrugë dhe të mbështeste zhvillimin e marrëdhënieve të reja që u vendosën.

Në këto kushte, praktikatat që u zbatuan në Shqipëri gjatë këtyre shtatë vjetëve ishin të diktuar nga rrethanat e tranzicionit dhe, për pasojë, ato shpesh nuk përputheshin me Kodin e Punës që hyri në fuqi në 23.8.1995.

Meqenëse ky Kod parashikonte shumë elemente të reja, u desh një periudhë kohe prej 7 vjetësh që të realizohej zbatimi më i saktë i tyre dhe u vërejtën në praktikë edhe mangësi në disa drejtime kryesore:

Drejtimi i parë ku janë vërejtur mangësi është lidhja e kontratës së punës.

Megjithëse Kodi i Punës (neni 21) përcakton mjaft qartë formën e kontratës së punës dhe elementet e saj, u vërejt se në shumicën e rasteve lidhja e marrëdhënies së punës bëhej edhe pa kontratë të shkruar, pa u pajisur punëmarrësi me librezën përkatëse dhe pa u shënuar në regjistrin përkatës të punonjësve.

Mungesa e kontratës sillte pasoja tepër të dëmshme, pasi kjo mungesë jo vetëm që i linte pa përcaktuar kushtet e punës, por edhe e bënte shumë të vështirë për punonjësën të provuarin e ekzistencës së këtyre marrëdhënieve dhe për pasojë, ai mund të pushohej në çdo çast nga puna, t'i shkeleshin të drejtat dhe ai nuk mund të mbrohej.

Drejtimi i dytë konsiston në zbatimin e mënyrës së dhënies dhe të përdorimit të pagës.

Pagat që zbatohet në sektorin publik dhe privat për subjektet e Kodit të Punës, përgjithësisht janë shumë të vogla, të tilla që nuk plotësojnë as nevojat minimale të jetesës. Mungesa e një page minimale të detyrueshme e të përcaktuar me ligj, kërkesa më e madhe se oferta në tregun e punës për shkak të dyndjeve të mëdha të fshatit në qytet gjatë këtyre viteve, krijuan kushte që punëdhënësit të abuzojnë.

Nuk paguhej puna tej kohës normale ose shtesa për orët e natës dhe pse kjo parashikohet në Kodin e Punës.

Në pagat që zbatohen nuk dalloheshin qartë përbërësit e tyre dhe, për pasojë, shpesh punonjësit nuk e dinin se cila ishte paga e tyre bazë, cilat janë ndalesat ligjore që bëhen prej saj dhe cilat janë shtesat e detyrueshme.

Në Kodin e Punës janë trajtuar hollësisht këto probleme, domethënë shpërblimi për punën e kryer, kohëzgjatja e ditës dhe e javës së punës, pushimet javore dhe ato vjetore, puna e natës dhe puna tej kohës normale të punës.

Është përcaktuar se paga ose shpërblimi për punën e kryer është elementi kryesor i marrëdhënieve të punës dhe, si e tillë ajo rregullohet e përcaktohet nga kontrata individuale e punës.

Legjislacioni shqiptar parashikon tri lloje pagash: Pagë e llogaritur me kohë, pagë sipas kohës së kryer (pagë me njësi), pagë në funksion të rezultateve të ndërmarrjes.

Paga e punonjësit është e paprekshme, ajo mund të caktohet vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

Kodi i punës parashikon edhe disa garanci për pagën e punonjësit. Si të

tillë mund të përmendim: Barazinë e pagës midis sekseve, pagën që nuk mund të jetë më e vogël se minimalja e parashikuar nga Këshilli i Ministrave.

Për çdo vonesë në pagimin, punëdhënësi paguan një interes vjetor baraz me 10 qind për qind të pagave të vonuara dhe jo më pak se 15 për qind të inflacionit të periudhës së vonesës.

Në rast paaftësie paguese të punëdhënësit, ka përparësi pagesa e pagave të punonjësve.

Ndryshimet e bëra në Kod me ligjin nr.9125, datë 29.7.2003 saktësojnë mënyrat e dhënies dhe të përdorimit të pagës, veçanërisht zëvendësimin e minimumit jetik me pagën e paprekshme, në rastet kur punëdhënësi kompenson pagën me kredi ndaj punëmarrësit, sidomos ndryshimet e neneve 122–123.

Drejtimi i tretë ka të bëjë me trajtimin e kohës së punës dhe të pushimit.

Gjatë zbatimit të Kodit të Punës është vërejtur se nuk janë respektuar dispozitat e sanksionuara në të, pasi nuk respektohet koha e punës ditore e javore, pushimi javor e vjetor, kushtet higjiëno-sanitare, kushtet teknike, pranohen në punë të mitur nën moshën 16 vjeç, duke mos iu respektuar atyre të drejtat e veçanta që u njeh ligji.

Këto mangësi manifestohen shpesh në sektorin privat.

Për këto, Kodi i Punës përcakton mjaft qartë kushtet dhe kohën e punës.

Koha e punës llogaritet në kohë ditore e kohë javore, por për respektimin e tij është vendimtar respektimi i maksimumit të parashikuar nga Kodi për kohën javore të punës, që nuk mund të jetë më e gjatë se 48 orë. Brenda këtij kufiri bëhet përcaktimi i kohës ditore të punës, që mund të jetë më pak se 8 orë në ditë.

Ndryshimet e reja të Kodit me ligjin e lartpërmendur parashikojnë, gjithashtu, sigurimin dhe mbrojtje më të mirë të punëmarrësve në punë nëpërmjet uljes së kohëzgjatjes javore të punës nga maksimumi në 48 orë, në maksimumin 40 orë, si dhe kohëzgjatjen e pushimeve vjetore me pagesë nga jo më pak se 3 javë në jo më pak se 4 javë kalendarike, harmonizimin e

kompensimit të shtesës së pagës me shtesën e pushimit për punën e kryer në ditët e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare.

Këto ndryshime janë bërë në përputhje me kërkesat e neneve 1 e 2 të Kartës Sociale Europiane të ndryshuar, të ratifikuar duke marrë në konsideratë edhe kohën javore të punës prej 40 orësh dhe kohën e pushimeve vjetore prej 4 javësh në sektorin shtetëror.

Për të miturit nën 18 vjeç dita e punës nuk mund të jetë me e gjatë se 6 orë. Përrjashtimisht, kur e kërkojnë rrethanat, punëdhënësi mund të kërkojë nga punëmarrësi kryerjen e orëve shtesë, por pa kaluar afatin e 50 orëve në javë. Ky autorizim mund të shkelet vetëm me autorizim të Inspektoratit të Punës, në raste të forcave madhore ose të punëve urgjente në favor të popullatës. Natyrisht puna tej kohës normale kompensohet me një shtesë page 25 për qind më të madhe dhe në rastet kur puna tej kohës normale kryhet ditën e pushimit javor ose ditët e festave kompensimi është 50 për qind më i madh.

Për shkak të vështirësive që paraqet puna në orët e natës, ajo nuk lejohet për të miturit nën 18 vjeç, për gratë shtatzëna dhe për persona të deklaruar invalidë.

Ndryshimet e reja të Kodit sigurojnë një mbrojtje më të mirë në punë për të miturit dhe për gratë shtatzëna, me fëmijët në gji dhe shmangien e abuzimit e punëdhënësit, si dhe përcaktojnë punë të vështira dhe të rrezikshme në përputhje me direktivat ndërkombëtare.

Një aspekt i rëndësishëm, i cili ka hasur mjaft probleme në praktikë, është përfundimi i marrëdhënies së punës.

Praktika e këtyre viteve ka treguar se në interpretimin e dispozitave të këtij kreu janë hasur shumë vështirësi dhe, për rrjedhojë, ato janë zbatuar me mangësi, gjë e cila është reflektuar edhe në vendimet e gjykatave.

Gjatë praktikës, duke qenë zgjidhja e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme, zbatohet për herë të parë në Shqipëri, u hasën vështirësi jo vetëm për pranimin e saj si koncept, por edhe për zbatimin në praktikë, pasi u vu re se në trajtimin e këtij problemi kishte mangësi të mëdha.

Përsa i përket zgjidhjes së kontratës për shkaqe të arsyeshme, ligji nuk përcaktonte se kush mund të ishin këto shkaqe, por ia linte në kompetencë gjykatës, e cila do të shqyrtonte konfliktin, që të çmojë nëse shkaqet për zgjidhjen e kontratës janë të arsyeshme ose jo. Vetëm një ishte kushti ligjor që duhej provuar në këtë rast: faji i rëndë në veprimet e punëmarrësit.

Sipas kësaj logjike nënkuptohet se ku mungon elementi *faj i rëndë në veprimet e punonjësit*, zgjidhja e kontratës nga ana e punëdhënësit duhej të konsiderohej pa shkaqe të arsyeshme.

Pikërisht këtu qëndronte edhe kontradikta në trajtimin që i bënte këtij problemi Kodi i Punës.

Sipas nenit 146, konsiderohej zgjidhje e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme jo kur mungon elementi *faj i rëndë në veprimet e punonjësit*, por ku ekzistonin disa rrethana të përcaktuara shprehimisht në këtë dispozitë.

Atëherë lindte pyetja: Si do të trajtohej zgjidhja e kontratës së punës që nuk e ka elementin *faj i rëndë në veprimet e punonjësit*, por, nga ana tjetër, nuk ka asnjë nga elementet e nenit 146? Pra, Kodi i Punës nuk e zgjidhte këtë problem.

Për arsyt e mësipërme lindi nevoja e ndryshimeve, të cilat konsistojnë si vijon:

A) Saktësimi i afateve dhe qartësimi i procedurave të pushimit nga puna, duke i lënë barrën e provës punëdhënësit, i cili duhet të provojë nëse është zbatuar procedura e pushimit nga puna.

Në rastin e mosrespektimit të procedurës së pushimit nga puna nga punëdhënësi, parashikohej pavlefshmëria e zgjidhjes së kontratës, por që punëmarrësi të përfitonte pagën duhej që të vihej në dipozicion të punëdhënësit, gjë e cila në praktikë nuk ka ndodhur.

Ndaj është menduar, që është më praktike dhe më e favorshme për punëmarrësin, që zgjidhja e kontratës të konsiderohet e vlefshme dhe, për mosrespektimin e procedurës, punëdhënësi t'i paguajë punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me dy paga mujore.

Gjithashtu, është menduar se kjo procedurë, si rregull, duhet të zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës.

B) Saktësimi që ka të bëjë me personalitetin e punëmarrësit, i cili ka për qëllim që t'i konsiderojë abuzive shkaqet e pamundura në këtë nen, mbasi ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me respektimin e detyrimeve kushtetuese dhe të ligjit. Për këtë arsye është menduar që zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi të jetë e pavlefshme për shkaqe abuzive.

C) Mbrojtja e punëmarrësit, në rastin e pushimit nga puna, edhe gjatë kohës kur ai është duke kryer shërbimin ushtarak, është me leje të zakonshme ose me pushime të tjera të dhëna nga punëdhënësi.

Ç) Saktësimi i shkaqeve të pushimit kolektiv nga puna, të cilat kanë të bëjnë me punëmarrësin dhe numrin e punonjësve të pushuar brenda afatit 90-ditor në varësi të numrit të punonjësve të ndërmarrjes.

Këto ishin çastet me të rëndësishme, ku në praktikë u vërejtën mangësi të shumta gjatë zbatimit të Kodit të Punës, çaste, të cilat me kalimin e kohës dhe me përsosjen e marrëdhënieve të punës në sistemin që po jetojmë dhe me përsosjen e mëtejshme të legjislacionit të punës, do të zbatohen më drejt.

Aspekte të funksionimit të kuvendit krahinor në të drejtën dokesore

Nebi Bardhoshi
Jurist / etnolog

Sistemi i vendimmarrjes në grup, përgjithësisht, dhe ai në të drejtën dokesore* në veçanti, ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e shumë studiuesve të fushave të ndryshme. Disa nga temat e veçanta që kanë ngjallur me shumë interes janë: formimi dhe roli i organeve vendimmarrëse, përfaqësimi e sistemi i vendimmarrjes në to, objekti dhe natyra e vendimmarrjes e me radhë. Në mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të këtyre organeve pasqyrohet si në miniaturë organizimi ekonomik-shoqëror në bashkësinë përkatëse, shtresëzimet shoqërore, kulturore, politike, ekonomike, sistemi i vlerave e shumë e shumë fije të tjera të jetës në bashkësi. Përgjatë zërthimit të sistemit të vendimmarrjes në tërësi vetvetiu dalin në pah edhe aspekte të tjera të jetës shoqërore si pozita e individit në atë shoqëri, mendësia mbizotëruese, prirjet shoqërore, praktikiteti, po dhe ajo që na intereson më tepër: duket qartë shkalla e demokracisë e format e saj, gjithmonë për aq sa ka ekzistuar. Në këtë shkrim do të mundohemi të pasqyrojmë disa aspekte të mënyrës së organizimit e të funksionimit të organit më të lartë vendimmarrës në krahinë** , sipas të drejtës kanunore, kuvendit. Po duhet thënë

* Çabej, E., *Studime Etimologjike në Fushë të Shqipërisë III*, Tiranë, ASH, 1987, f. 277. Fjala “doke” në fjalorin e drejtësisë popullore merr cilësinë e fjalës: zakon, normë, rregull,

** Me “krahinë” kuptojmë “një trevë të caktuar, ku prej kohësh në një mjedis gjeografik të caktuar banon një bashkësi ekonomike-shoqërore, me kushte shoqërore dhe me mënyrë të përbashkët jetese...” Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, ASH, 1985, f. 543.

se organe të kësaj natyre kishin edhe bashkësi si vëllazëria, fshati a grup fshatrash, bajraqe etj. Ndërsa si periudhë kohore është marrë gjysma e dytë e shekullit XIX, nga i kemi më së shumti të dhënat dhe deri në kohën kur veprimtaria e këtij organi u zëvendësua nga funksionimi i organeve përkatëse shtetërore.

Materialet që u shfrytëzuan janë botime, shkrime, përmbledhje të autorëve të ndryshëm, si dhe të dhëna të tjera të mbledhura nga autori në ekspedita eksploruese.

INSTITUTI I KUVENDIT NË TË DREJTËN DOKESORE

Marrja e vendimit në kuvende bëhej duke zbatuar parimet bazë të së drejtës dokesore¹. Në të njëjtën kohë, edhe kjo e fundit ishte rrjedhojë e një forme të caktuar të organizimit ekonomiko-shoqërore e që në fakt përkon me një sistem patriarko-fisnor, ku partikulariteti ishte dukuri, por që ndyshimet mes krahinave qëndronin si dytësore për nga rëndësia, në raport me të përbashkëtat². E drejta dokesore nuk u kodifikua asnjëherë nga ndonjë organ legjislativ, autentik siç mund të ishte ta zëmë kuvendi. Kodifikimi i bërë nga mbledhës ose studiues të ndryshëm nuk duhet ngatërruar me këtë proces. Në vazhdim duhet të ritheksojmë se ishin këto kuvende që u bënë dhe organi që herë pas here, në bazë të nevojave që i dilnin bashkësisë krahinore në jetën e përditshme, plotësonin të drejtën popullore nga ndonjë zbrazëti, ripërforconin një normë, shfuqizonin një normë të vjetër, duke e zëvendësuar me një të re ose e risonin etj. Madje në ndonjë krahinë, si p.sh. në Kurbin, në vitin 1906 u mblodh kuvendi krahinor, ku ndër të tjera vendosi mbrojtjen e zbatimit të së drejtës tradicionale popullore, duke përcaktuar dënime konkrete

¹ Ulqini, K, *Veprimtaria kanunore e pleqësore në institucionin e bajrakut*, "Etn. Shq.", XIV, 1985, f.. 224.

² Tirta, M., *Emlogjia e Shqiptarëve*, Tiranë, Geer, 2003, f. 372.

për ata që iu drejtoheshin gjykatave turke³. Në të folmen popullore dhe në kanune të mbledhura gjejmë terma si “*në kanu të vjetër*” “*më kanu të ri*”, që në fakt nuk kemi të bëjmë aspak me dukuri të tilla, po me një vazhdimësi të traditës juridike në përshtatje, risi që i kërkonte koha⁴. Thënë ndryshe, e drejta kanunore nuk ishte një e drejtë statike, po, me gjithë se me ngadalësi, ajo zhvillohej e një ndihmesë të veçantë për këtë jepte kuvendi krahinor me pleqnarë, me njerëz të urtë.

FUSHA E VEPRIMTARISË

Thirrej për t’iu dhënë rrugëzgjdhje problemeve, që pavarësisht nga natyra e tyre, drejpërsëdrejti a tërthorazi kishin prekur interesat e të gjithë pjesëtarëve të krahinës. Fakti se në çdo kohë kuvendi si institucion ishte i prirur për të dhënë zgjidhje të arsyetuara, kuptimplote, në përshtatje me mendësinë e banorëve, i dha atij një funksion e autoritet të pazëvendësueshëm. Tematika që kërkonte trajtim mund të kishte karakter politik, pronësor, familjar, penal etj. Do të veçonim si më karakteristikët: besëlidhjen krahinore e ndërkrahinore për mbrojtje; besën për lëvizje të lirë a për qëllime të tjera; vendosjen e rregullave rreth lejimit ose jo të martesës brenda krahinës etj. Mund të themi se për natyrën e çështjeve që kërkonin një vendimmarrje të re nuk kishte ndonjë kufizim dokesor paraprak, përveç respektimit të parimeve bazë kanunore dhe fushëveprimit lëndor e hapësinor. Ky institucion nuk mund të ndërhynte në trajtimin e ndonjë çështjeve që ishte në kompetencë të një organi tjetër si, ta zëmë, për ato që ishin në kompetencë të kuvendit të një fshati, vëllazërie etj. Në anë tjetër, autoritetin për të dhënë një rrugëzgjdhje të drejtë, në përputhje me natyrën e këtij korpusi, më mirë se çdo organ

³ Gjeçovi, Sh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë, 1972, f.129.

⁴ Ulqini, K., vep. cit. 225.

tjetër e kishte kuvendi. Fuqia vepruese e vendimeve kuvendore, juridiksioni në aspektin territorial, shtrihej kryesisht vetëm në hapësirën gjeografike të krahinës përkatëse. Ndonjëherë ka pasur edhe raste që janë bërë përpjekje që vendimet e kuvendit të një krahine të njiheshin si të vlefshme edhe për njësi më të vogla a krahina të tjera⁵.

FORMAT KRYESORE ORGANIZATIVE, KOHA

Një grup çështjesh trajtoheshin periodikisht. Ta zëmë, çdo pranverë rifreskohej marrëveshja krahinore për respektimin e rrugës së madhe. Ndërkohë, trajtimi i çështjeve të tjera ishte në varësi të nevojave që lindnin në jetën e përditshme në kohë të pacaktuar, të paparashikuara, si p.sh., të vendosjeve rreth konfliktit të lindur në mes dy fshatrave pjesëtare të krahinës (Hasluck, M, 1954, f.488). Kuvendet, që zakonisht mblidheshin dy herë në vit, afër festës së Shëngjergjit (pranëverë) dhe Shënmitrit (vjeshtë), edhe më 20 a 25 mars, nga shumë studiues janë quajtur të *zakonshme*, kurse të tjerat, kuvendet, që trajtonin problematikën joperiodike u emërtuan të *jashtëzakonshme*⁶. Kriteri bazë që është ndjekur për kohën e thirrjes së krahinës në kuvend duket qartë të ketë qenë praktikiteti, sepse në të dy kohët, përkatësisht në të dalë të dimrit, si dhe në të hyrë të tij, lypsej të merreshin masa të reja e të rikonfirmoheshin ato të vendosura më parë, në mënyrë që jeta e bashkësisë të ishte në rregull. Po i njëjti vlerësim mund të jepet edhe për kriterin e mbajtjes së kuvendit për rastet e sapokrijuara.

Thirrja e përfaqësuesve në kuvend bëhej me lajmëtar⁷, i cili kishte

⁵ Hasluck, M., *The Unwritten Law of Albanian*, Cambridge at the University Press, 1954, AE-IKP (përkth), f.492.

⁶ Hoxha, Sh., *Instituti i Kuvendit në Lumë*, Tiranë, Geer, 2002, f.69, &.

Uliqini., K., *Dukuri të organizimit të vjetër shoqëror në Himarë e në Sul*, Tiranë, “Etn. Shq.”XV, 1987, f.225.

⁷ Uliqini., K., e cit. “Etn. Shq”, XV. F.225.

për detyrë të njoftonte derë më derë ose vetëm te të *parët* e vëllazërive* , sipas rastit⁸ . Në rastin kur lajmëtari ia linte fjalën të *parit* të vëllazërisë, ky i fundit kishte për detyrë që të vinte në dijeni të gjithë të *parët*, zotët e shtëpive pjesëtarë të vëllazërisë së tij. Thirrja e kuvendit që kishte të bënte me një gjendje të re, siç ishte si e thamë më lart, bëhej edhe me zë nga larg, me *kushtrim*⁹ . Në disa raste në brendinë e kushtrimit mund të thuhej edhe shkaku i thirrjes.

NATYRA E VEPRIMTARISË

Kemi thënë se shkaqet, për të cilat një kuvendi krahinor i duhej të mblidhej për të vendosur, ishin të larmishme. Vendimet dhe e gjithë veprimtaria e kuvendit janë shprehje e një ndërthurjeje aq komplekse kompetencash, sa është e vështirë të vihet një përcaktim i prerë nëse vendimet e veprimtaria e tij në përgjithësi janë të natyrës legjislativë, gjyqësore ose ekzekutive. Një gjë e tillë është burim i shumë faktorëve, po veçanërisht nga vetë forma e organizimit shoqëror. Por, në anë tjetër, edhe pse nuk ka një kufi krejt të qartë funksionesh, në kuptimin e sotëm të organizimit shtetëror, mund të themi se në analizë të tërësisë së vendimeve e veprimtarisë, në kompetencë të kuvendit përfshiheshin të tri kategoritë funksionale, po më tepër ato me karakter legjislativ¹⁰ . Kështu, ta zëmë, për lidhjen e një “*bese*”, kuvendi përcaktonte të gjitha rregullat përbërëse të saj, në anë formale: Kuvendi

* Me termin vëllazëri zakonisht kuptohet një grup i caktuar familjesh, numri i të cilave mund të variojë nga 2, 3, 4 deri në dhjetra, të parët e tyre kanë qenë vëllezër. Në vise të ndryshme të vendit tonë, organizma të tillë shoqëror marrin emërtesa të ndryshme si: çeta (në Labëri), fara (Sul), kushrinj (Mirditë, Pukë).

⁸ Meçi, Xh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit, varianti i Mirditës*, Tiranë, “Geer”, 2002, f. 85.

⁹ Stalh, H., P., *The Household, Village and Village Confederation in Southeastern Europa*, New York, “Columbia University Press” (përkth), 1986, AE IKP, f. 136.

¹⁰ Elezi, I., *E drejta zakonore e Labërisë*, Tiranë, Toena, 2002, f. 105.

mbilidhej e gjykonte nëse kjo besë është zbatuar si duhet ose jo e, po ky institucion merrte masat për ekzekutimin deri në fund të kësaj marrëveshjeje (besës). Në praktikë ka ndodhur që disa vendime, megjithëse në anë formale plotësonin të gjitha kërkesat, nuk kanë gjetur zbatim. Mosvënia e tyre në jetë mendojmë të ketë ardhur nga që vendimmarrësit nuk kanë mbajtur parasysh një kriter tjetër shumë të rëndësishëm, siç ishte psika, hierarkia e vlerave ndër banorët e trevës. Kështu, për shqiptarët e kësaj periudhe më shumë se respektimi i martesës monogame kishte rëndësi pasja me çdo kusht e një trashëgimtari, sidomos djalë. Në këto rrethana ishte *paria* ajo që mundahej, për shkaqe të caktuara, të imponohej. Kjo gjë vihet re në përsëritjen e vendimeve me të njëjtën tematikë. Ndër të tjera Hasluck shprehet: “*prapë në 1894 Kastrati vendos dënim për një burrë që merr një grua mbikurorë...*” (shih. Hasluck. M. 1954 f. 491). Këto raste vihen re rrallë, aq sa nuk prekin në thelb shkallën e lartë të zbatueshmërisë së vendimeve.

PËRFAQËSIMI NË KUVENDIN KRAHINOR

Ato treva, që si rregullator të jetës së tyre në tërë aspektet mbajtën të drejtën dokesore, nuk e njohën të drejtën shtetërore të pushtuesve¹¹. Nga kjo, vetvetiu kuptohet se vullneti i tyre politik në përfaqësim shprehej vetëm te organet e krijuara sipas së drejtës popullore tradicionale ku, në anën tjetër, e drejta shtetërore nuk zgjidhte gjithë problemet e tyre jetike¹². Sipas të drejtës dokesore shqiptare, subjekti që gëzonte të drejta të barabarta e të pakufizuara përfaqësimi ishte *familja* dhe jo individ. ¹³ Një gjë e tillë shfaqet në çdo marrëdhënie ekonomiko-shoqërore, porse si *përfaqësues* interesash të saj, familja kishte të *zotin* e shtëpisë e, në raste përjashtimore, edhe e

¹¹ Sufflai, M., *Serbët dhe Shqiptarët.*, Tiranë, Bargjini, 1996, f.69.

¹² Tirta, M., vp. cit., Tiranë, Geer, 2003, f. 389

¹³ Valentini., Gi., *Il diritto della comunita delle Montagne Albanese*, Firenze, 1956, f. 17.

zonja e shtëpisë¹⁴. Pa vendim të kuvendit asnjë familje nuk përjashtoj nga e drejta e përfaqësimit, madje as familjet e *ngujuara*¹⁵. Përveç kur një a disa familje më parë ishin *leçitun* ose përzënë nga krahina. Veç pasojave të tjera që kishin këto forma ndëshkimi, ishte edhe heqja e të drejtës së përfaqësimit: “*i dbuemi dhe i leçit nuk hinë në burrat e dheut*” (shih. KLDVM. 2002 f. 83).

FORMAT E PËRFAQËSIMIT

Në praktikë viheshin në zbatim kryesisht dy forma të demokracisë përfaqësuese të natyrës patriarkore-fisnore. Në njërën formë, në kuvend merrnin pjesë vetëm kryetarët e vëllazërive¹⁶, që ishte përfaqësim në dy shkallë. Themi dy shkallë, sepse individit, madje edhe meshkujt e një familjeje, përfaqësoheshin nga i *zoti i shtëpisë (familjes)*. Veç kësaj, edhe vetë ky i fundit, në këtë formë përfaqësimi, nuk merrte pjesë vetë në kuvend, porse interesat e familjes së tij i përfaqësonte i *pari i vëllazërisë*, anëtare e së cilës ishte familja që ky përfaqësonte. Në rast se *plaku i parë* vdiste ose për arsye të ndryshme nuk ishte në gjendje të përfaqësonte më vëllazërinë, atëherë, me marrëveshje nga familjet e vëllazërisë, caktohej si pasues i tij djali i tij i madh ose më i zgjuari, ose vëllai i tij në qoftë se ishte gjallë etj. Përcaktimi i *plakut*, që do të përfaqësonte vëllazërinë, ishte në kompetencë të plotë të vëllazërisë. Si kritere përcaktuese, për t’u zgjedhur si plak i parë, ishin zotësia dhe mençuria e shfaqur më parë¹⁷. Në qoftë se një familje

¹⁴ Halimi, K., *Trajtime dhe studime etnologjike*, Prishtinë, IAP, 2000, f.47.

¹⁵ Ulqini, K., e cit. “Etn. Sh.”XV. F.225.

¹⁶ Elezi, I., vp. e cit. f. 105.. &., Ulqini, Kahreman., vep. cit. “Etn. Shq” XV,f. 270. shih. KLD, KS, KLDVM., KLDVP.

¹⁷ Ekspeditë eksploruese, Has, 02.-24.10.2002 &Kurbin, 05-09. 07.. 2003. (materiale të gjenden në AE- IKP)

kishte gëzuar atributet e të parës, ajo e humbiste këtë cilësi që në çastin që largohej nga vendi ku ndodhej, jashtë krahinës.¹⁸

Një demokraci disi më të zgjeruar në krahasim më të mësipërmen, kemi në kuvendet që mblihdeshin sipas parimit “*burrë për shtëpi*”. U emërtua kështu se nuk përjashtohej mundësia që në vend të të *parit* të familjes të shkonte një përfaqësues tjetër¹⁹. Në bazë të kësaj forme, çdo familje do të kishte përfaqësuesin e saj në kuvend²⁰. Këto dy forma përfaqësimi nuk duhen kuptuar si të shkëputura nga njëra-tjetra, sepse ishte kuvendi i pjeshëm “i të parëve” që vendoste se kur dhe për çfarë duhej të thirrej kuvendi i përgjithshëm, “burrë për shpi”, gjë të cilën e bënte me një seancë paraprake. Shkak për thirrjen e një kuvendi të tillë ishte vetë natyra e çështjes, ishin disa raste të veçanta, si p.sh. vendosja e një norme të re, kërkonte medoemos një vendimmarrje më të gjerë, për të vendosur për të drejtat e detyrimet që rridhnin prej saj. Natyra e institucionit të kuvendit dhe autoriteti i tij jepnin garancinë e nevojshme që çdo familje të kishte mundësi faktike për të ushtruar të drejtën e marrjes pjesë në kuvendim, për më tepër ky institucion kishte të drejtë që të merrte *në ndore* (në mbrojtje) edhe persona që në kohën që ishte i mbledhur i kërkohej mbrojtje. Në rast se dikush nuk e respektonte *ndoren* dhe e vriste kërkuesin e saj, kuvendi kishte të drejtë ta vriste shkelësin dhe familjen e tij ta përzinte nga krahina²¹. Asnjëra nga familjet pjesëtare të së cilave kishin qenë dy të vrarët nuk kishte të drejtë të hakmerrej ndaj tjetrës, sepse drejtësinë e kishte dhënë kuvendi. Barazia në përfaqësim mes vëllazërive a familjeve nuk ndikohej nga numri i ndryshëm i familjeve në vëllazëri ose nga numri i frymëve në familje. Ta zëmë, një vëllazëri mund të përbëhej nga 10 familje, ndërsa tjetra

¹⁸ Ekpeditë eksploruese, Has, 02.10. 2003. & Në Kurbin, 05. 07.2003.

¹⁹ KLDVM., vep. cit. f. 83., &.,

²⁰ KLD, vep. cit. n. 27, f.. 9, &, EDZL, vep. cit. f.105.

²¹ KLDVM., vep.cit., f. 87.

dyfishin a më shumë, po që në kuvend kishin nga një zë secila (d.m.th një votë) dhe po kështu me familjet të cilat në brendi të tyre kishin numër të ndryshëm nga një deri në dhjetra, në kuvend kishin një përfaqësues.

VENDI I ZHVILLIMIT TË PUNIMEVE

Në shumicën e rasteve, si në formën e përfaqësimit “*me pleqtë e parë*” dhe “*burrë për shpi*” duhej të dihej vendi se ku do të zhvillohej kuvendi. Vendi ishte i njohur botërisht dhe, në shumicën e rasteve, ishin në qendër të krahinës ose afër kishës e xhamisë, “*vendi i kuvendit, në zemër të vendit*” (KLDVP, n. 179, f.76). Në ato raste ku një krahinë kishte dy a më shumë vende kuvendesh ose e ndryshonte për ndonjë arsye, kuvendarët duhet të viheshin në dijeni nga lajmëtari²². Jo rrallë, si vende për të zhvillur kuvendimin përdorehin shtëpi me hapësirë të mjaftueshme, sidomos kur ishte moti i keq. I pari i krahinës ishte personi që e hapte mbledhjen, ku tregonte edhe njëherë se përse ishin mbledhur. Në të dy format e kuvendeve, sipas përfaqësimit, burrat zakonisht uleshin në formë gjysmërrethi (vendi i parë niste nga mesi i pjesës harkore), në mënyrë që të pranishmit të shihnin njëri-tjetrin kur flisnin. Secili përfaqësues e dinte se ku duhet të ulej. Me radhën e vendeve të uljes është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe radha e fjalës. Për respektimin e saj kujdeseshin si paria dhe vetë pjesëmarrësit, të cilët kishte raste që, edhe pse i ftonte dikush më lart nga sa i takonte të ulej, nuk pranonin²³. Thamë që radha e marrjes së fjalës vinte sipas radhës së vendosjes për nga dy krahët e kreut, po duhet të sqarojmë se kjo radhë ishte e paravendosur më tepër në varësi të vjetërsisë e autoritetit të vëllazërive dhe jo nga mosha ose cilësitë e individit përfaqësues. (KLD., 1972 pg.1117., & Stahl. P. H., 1986. f.132). Në jo pak raste ndodhte që fjala t’i jepej pa

²² Meçi, Xh., *Roli i Kuvendit...*, Tiranë, “Kult. Pop.”, 1982, f. 162.

²³ P, Dodë., D, Zef., *Nikaj-Mërtur*, Shkodër , Shtjefini, 2003, f. 88.

radhë atij që njihej nga të gjithë për zgjuarsinë e tij ose për rastin konkret kishte më shumë dijeni.

DISA NORMA ETIKO-JURIDIKE

Për mirëfunksionimin e punimeve kuvendare ekzistonte një kod i pashkruar etiko-juridik, si një rregullore e brendshme, në bazë të të cilit zhvilloheshin punimet. Sipas tij nuk lejohej që ndokujt në kuvend t'i thuhej që gënjen, t'i flisje me tone të ashpra a fyese ose t'ia ndërprisje fjalën, sepse kjo konsiderohej jo vetëm një fyerje e madhe për vetë personin, familjen a vëllazërinë e tij, po kjo ishte një cenim i vetë mirëfunksionimit të punës së kuvendit. Ndëshkimet për këto shkelje varionin nga gjoba: “*po i the kujt se rren*” (NB. në Kuvend), deri në 500 grosh (KLD. pg.1124) dhe deri në vrasje e dëbim për fajtorin e familjen e atij që i shkrep pushkën dikujt në kuvend (KLD.pg.1125). Personi, kur fliste në kuvend bënte kujdes të fliste me mençuri, ngadalë në mënyrë bindëse, argumentuese, siç thoshte populli (në Kosovë): “me thanë *fjalë petajka (të sheshta)* e jo gogla”, pra që të zinin vend kur thuheshin e jo të shkonin duke u rrotulluar (nga studiuesi Halimi. M). Të tjerët që ishin në prani të qëndronin dëgjonin në heshtje (KLD, 1972.pg. 1118). Urtësia ishte kusht, se siç thotë një fjalë e urtë: “*trimëria pas lufte e urtia pas kuvendi nuk vlejnë*”. Nxitimi a acarimi në të shprehur qoftë edhe pa fyerje ishin shenjë papjekurie. Për këto raste si nuk kishte ndëshkime të karakterit penal po ndaj një sjellje të tillë mbahej qëndrim kritik, qortues. Në Nikaj-Mërtur ekzistonte shprehja në formë mallkimi “*Tu preftë fjala n'kuvend burrash*”²⁴.

VENDIMMARRJA NË KUPTIM TË NGUSHTË

Në përgjithësi, vendimet merrreshin njëzëri²⁵, pa kundërshtime. Mendojmë

²⁴ Progni D ., Doda, Z, vep. cit. f. 87.

²⁵ Elezi,. I., vep. cit. f.66.

se veç tjerash kjo ndodhte për dy arsye, së pari: vendimet ishin në interes të të gjithëve, si p.sh. moscenimi i kufijve, i rrugëve, i bjeshkës, mbrojtja territoriale. Së dyti: ndëshkimet, që mund të pësonte ai që kundërshtonte, ishin aq të ashpra sa më mirë ishte heqja dorë nga pretendimet. Në qoftë se një ose më shumë grupe të përfaqësuara në kuvendet e përgjithshme “*burrë për shpi*”, vegjëlja në përgjithësi ose një vëllazëri e caktuar nuk ishin në një mendje më atë që kërkonte paria, atëherë vendosej që kuvendi të shpërndahej për pak kohë. Pas shpërndarjes në grupe-grupe, sipas vëllazërive, kuvendi rimblidhej, ku dhe një herë shpreheshin vullnetet nga e para. Kur nuk arrihej marrëveshje lihej që të mbledheshin të nesërmen në të njëjtën kohë. Si ditën e parë, ashtu dhe në të dytën ishte zakon, në disa krahina, mbledhja të bëhej pasditeve dhe mundësisht kryhej i gjithë procesi para se të të perëndonte dielli. (KLDVP, n. 176.), po, gjithashtu, kishte edhe shumë treva që si kohë fillimi të punimeve kuvendare kishin mëngjesin²⁶. Punimet vazhdonin deri sa të jepej një vendim përfundimtar (KLDVM, f. 86 & Hoxha. 2002. 77.). Në rrethana të tilla, ku pakica kundërshtonte vendimin e shumicës, dhe më parë ishin bërë përpjekje që të arrihej një marrëveshje, shumica i imponohej pakicës (KLDVM, 2002, n. 151, f.83). Rastet e një kundërshtimi në praktikë nuk ndeshen shpesh. Familjet, që për shkaqe të arsyeshme nuk mund të merrnin pjesë në kuvend, viheshin në dijeni për gjithçka u vendos (KLDVM., 2002. f.86).

HYRJA NË FUQI, EKZEKUTIMI

Vendimi merrte formë të prerë kur burrat betoheshin për të pranuar e zbatuar këtë vendim si familje a si vëllazëri, betim që bëhej nga të gjithë pjesëmarrësit në kuvend. Në formën më të vjetër betimi bëhej mbi një gur, i cili pas bërjes së besës merrte cilësi shenjtërimi.²⁷ Vendimet, ashtu si

²⁶ Hasluck, M., vep. cit. f. 150.

²⁷ Gjeçovi, Sh., *Trashigimi Thrako-Ilire*, Shkodër, 'Hylli i Dritës', 1924, f. 551-552. & Tirta., Mark., *Kulti i Gurit ndër Shqiptarë*, Prishtinë, "Gjur. Alb.", 2001, f. 15-16.

merreshin, kryesisht me marrëveshje, ashtu dhe zbatoheshin. Shkelësi i tyre, si dhe i dokeve në përgjithësi nuk konsiderohej thjesht një moszbatues i një norme juridike, po në sy të banorëve të krahinës ishte edhe i pamoralshëm, i padenjë për atë shoqëri²⁸. Pra, edhe normat kuvendore në mënyrë të menjëhershme ishin kanunore, fitonin jo vetëm natyrë juridike po edhe morale dhe në jo pak raste, edhe kultike. Betimi a ndryshe dhënia e besës, e shoqëruar me një formulë sipas rastit, natyrës së çështjes etj., kishte si funksion njohjen dhe futjen në fuqi të menjëhershme të vendimit. Prej kësaj buronte edhe e drejta e drejtuesve krahinorë për të kërkuar vënien në jetë të vendimit, me arsyetimin se ke dhënë besën, fjalën dhe për banorët këto fjalë kishin një ngarkesë të madhe morale besimi e kultike. Këto përmasa të normave ishin edhe garanti më i mirë i zbatimit të vendimit.

Masat ndëshkimore ndaj moszbatuesit të një vendimi ishin të ndryshme si me gjobë, me përjashtim nga territori me ose pa afat, me vrasje etj. Për të gjitha rastet vendosej në raport të normave kanunore të shkelura me kushtet ekonomike-shoqërore të vendit dhe shkallën e shkeljes së vlerave të asaj shoqërie. P.sh., vlera e gjobës për të njëjtën vepër nga një krahinë në tjetrën ndryshonte në varësi të të mirave ekonomike që dispononte mesatarisht një familje²⁹. Interesant është fakti se vlera e gjobës e marrë prej të ndëshkuarit nuk i kalonte një individit a një grupi të caktuar shoqëror, siç ndodhte në vende të tjera pak a shumë me kushte ekonomiko-shoqërore të afërta me vendin tonë, po e gjitha shpërndahej a konsumohej për të gjithë anëtarët e bashkësisë në fjalë³⁰. Një veçori tjetër në natyrën e ndëshkimeve ishte dhe fakti se nuk jepeshin vendime të tilla që cenonin rëndë dinjitetin e individit. Gjetja në disa rrethina të vendit tonë e rasteve të zbatimit të dënimeve të tilla

²⁸ Tirta, M., vep. cit. f. 35.

²⁹ Hasluck, M., vep. cit. f. 501.

³⁰ Hahn., G. von., *Studime Shqiptare.*, Jena, 1854, AE-IKP. &., Ekspeditë në Kurbin, 05-09.10. 2003. AE-IKP.

si “*dënimi me pllakë ose dërrasë turpi*”, “*dënimi me prerje të gjymtyrëve*” etj. është shprehje e ndikimeve të së drejtës bizantine dhe kuranore,³¹ biblike.

NË VEND TË MBYLLJES

Zbërthimi ashtu si duhet i gjithë veprimtarisë kuvendare në të drejtën dokesore të shqiptarët kërkon përkushtim, kohë e dije të thella. Në këtu vetëm sa cekëm disa aspekte që menduam si më me interes. Lëvrimi i traditës popullore juridike nuk duhet të bëhet vetëm sa për kureshtje, po t’i jepet funksion praktik. Hartimi i ligjeve a politikave në tërësi, pa mbajtur parasysh etnopsikologjinë, traditën juridike popullore në veçanti, në çdo kohë krijon premisa për mosfunksionimin si duhet të tyre. Nuk bëhet fjalë për t’u nënshtruar të kaluarës, përkundrazi.

³¹ Elezi., I., vep. cit. f. 165.

Një instrument i ri për funksionin mbikëqyrës të parlamentit: Zyrat dhe delegacionet (Parlamenti francez)*

HYRJE

Për disa vjet rresht, Asambleja Kombëtare dhe Senati janë përpjekur të zhvillojnë kapacitetet e tyre diagnostikuese dhe hetuese, të cilat të operojnë në mënyrë të pavarur nga Qeveria, duke mos qenë pjesë e procesit nomativ. Qëllimi është të arrihen standarde më të mira në lidhje numrin në rritje të teksteve legjislative, duke iu paraprirë kështu zhvillimeve të ardhshme.

Për këtë qëllim janë krijuar institucione të ndryshme - të quajura zyra ose delegacione - të cilat nuk përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin legjislativ dhe operojnë në mënyrë të pavarur nga komisionet e përhershme. Misioni i tyre fokusohet në tri çështje kryesore:

- Monitorimi i zhvillimeve ligjore dhe teknologjike në fushat për të cilat këto delegacione janë përgjegjëse.
- Informimi i deputetëve.
- Vlerësimi i impaktit të vendimeve të marra nga institucionet kompetente të fushave për të cilat këto delegacione janë përgjegjëse.

Aktualisht, Senati ka tetë zyra dhe delegacione:

- Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Vendimeve në Lidhje me Çështje Shkencore dhe Teknologjike.
- Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Legjislacionit.

*Material i përgatitur për seminarin “Funksioni mbikëqyrës i Parlamentit:komisionet hetimore dhe e ardhmja e tyre”, organizuar nga UNDP dhe Kuvendi i Shqipërisë, 12 nëntor 2003

- Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Politikave të Shëndetit.
- Delegacioni Parlamentar për Bashkimin European.
- Delegacioni Parlamentar për Çështjet Demografike.
- Delegacioni Parlamentar për Planifikimin.
- Delegacioni Parlamentar për Planifikimin Urban dhe Zhvillimin e Qendrueshëm.
- Delegacioni Parlamentar për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore. Më poshtë jepen shpjegime për disa nga zyrat dhe delegacionet:

I. ZYRAT: NGA MBIKËQYRJE NË VLERËSIM

1. Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Vendimeve në Lidhje me Çështjet Shkencore dhe Teknologjike

Në fillim të viteve 1980, gjatë debateve në lidhje me vendimet që duhet të merreshin për programet bërthamore ose hapësinore, Parlamenti Francez vuri re se nuk ishte në gjendje të vlerësonte në mënyrë të saktë vendimet e Qeverisë në lidhje me politikat shkencore dhe teknologjike që duheshin ndjekur.

Për këtë arsye Parlamenti Francez vendosi të krijonte një institucion, i cili do të kishte si qëllim kryesor çështjen e vlerësimit: Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Vendimeve në Lidhje me Çështjet Shkencore dhe Teknologjike.

Qëllimi i institucionit të krijuar gjëndeje i shprehur në ligjin nr.83-609, datë 8 korrik 1983. Në këtë ligj thuhej: «*Qëllimi është të informojë Parlamentin për pasojat në lidhje me vendimet shkencore dhe teknologjike, në mënyrë që të mundësojë informacion të plotë gjatë procesit të vendimmarrjes*». Në këtë kontekst, kjo Zyrë «*mbledh informacion, implementon programe studimesh dhe bën vlerësime*».

PËRBËRJA

Kjo zyrë përbëhet nga 18 deputetë dhe 18 senatorë. Anëtarët e saj janë zgjedhur në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfaqësim proporcional të grupeve politike.

Deputetët zgjidhen në fillim të çdo legjislature dhe qëndrojnë në këtë pozicion deri në fund të saj, ndërsa senatorët zgjidhen sa herë që kryhet rinovimi pjesor i Senatit. Në fillim të çdo seance të zakonshme punimesh, delegacioni zgjedh Kryetarin e tij dhe Zëvendëskryetarin, i cili mund të mos i përkasë të njëjtës Dhome Parlamenti.

Tradicionalisht, posti i Kryetarit të Zyrës është subjekt i rotacionit midis dy Dhomave të Parlamentit për një periudhë kohore prej tre vjetësh. Rregullat e kësaj zyre theksojnë se Kryetari i parë duhet të zgjidhet nga Dhoma tjetër e Parlamentit.

MJETET E VEPRIMIT

Kërkesa, për çështjet që merren në shqyrtim, mund të bëhet nga Parlamenti me nismën e tij, me kërkesën e drejtuesit të një grupi politik ose me kërkesën e 60 deputetëve dhe 40 senatorëve, ose nga një komision i përhershëm, ose nga një komision i specializuar. Deri në çastet që flasim, çështjet që janë shqyrtuar nga kjo zyrë mund të kategorizohen në katër grupe kryesore: energjia, mjedisi, teknologjitë e reja dhe shkenca.

Disa kërkesa për studime të caktuara janë përsëritur për vite me radhë - siç është rasti i çështjeve për sigurinë e mjeteve bërthamore. Kërkesa të tjera janë bërë me qëllim rifreskimit e raporteve të hartuara më parë nga vetë Zyra (mbetjet bërthamore, industritë përpunuese etj). Përsëritja e kërkesës për studimin e vazhdueshëm të një çështjeje të caktuar siguron ndjekje efektive të problemeve të ndryshme.

Zyra vepron si ndërmjetës midis botës politike dhe mjedisëve (ekspertëve) kërkimore. Ajo duhet të mbajë lidhje me mjediset kërkimore dhe ekspertët. Zyra asistohet në punën e saj nga një Bord Shkencor, përbërja e të cilit reflekton diversitetin e disiplinave shkencore dhe teknologjike. Bordi përbëhet nga 24 individë të cilët janë zgjedhur në bazë të aftësive, njohurive dhe ekspertizës së tyre.

PROCEDURA

Çdo kërkesë pasohet nga emërimi i një ose më shumë «raportues» të zgjedhur nga anëtarët e Zyrës. Studime të ndryshme janë drejtuar në mënyrë të përbashkët nga një deputet dhe një senator.

- *Përgatitja e një studimi fizibiliteti*

Menjëherë pas emërimit, raportuesi fillon me hartimin e një studimi fizibiliteti. Ky studim ka si qëllim të sigurojë njohuritë bazë në lidhje me çështjen, të identifikojë fusha të mundshme për të bërë kërkime, të vlerësojë mundësinë e arritjes së rezultateve cilësore brenda një afati kohor të përcaktuar dhe të vlerësojë mjetet për zhvillimin e një programi studimi.

Më pas raportuesi paraqet rezultatet e studimit të fizibilitetit përpara anëtarëve të Zyrës, të cilat duhet të shoqërohen me shpjegime për metodologjinë e përdorur. Në vazhdim ai/ajo propozon një nga alternativat si: ndalimi i kërkimeve për çështjen në fjalë (ndodh shumë rrallë), sugjeron që hartuesi i kërkesës të riformulojë kërkesën (p.sh. një kërkesë që fillimisht lidhej me biokarbonet zgjerohet për të përfshirë edhe mundësitë për zhvillimin e produkteve agrokulturore joushqimore), ose, siç ndodh më shpesh, sugjeron fillimin e një programi studimor që do të përfundojë me hartimin e një raporti.

- *Hartimi i një raporti*

Me qëllim hartimin e një raporti, raportuesi zhvillon seanca dëgjimi që mundësojnë mbledhjen e informacionit, duke përfshirë të gjitha pikëpamjet e individëve ose të organizatave të përfshira në çështjen në fjalë. Ai/ajo mund të zhvillojë, gjithashtu, vizita në uzina ose kompani në Francë ose jashtë Francës, të cila kanë lidhje me çështjen që studiohet.

Gjatë kryerjes së studimit reporteri asistohet nga një staf i Parlamentit, ose nëse është e nevojshme, nga një grup pune i përbërë nga persona kompetentë, të cilët nuk janë anëtarë të Parlamentit. Ai/ajo mund të ftojë, gjithashtu, ekspertë vendas dhe të huaj ose të kërkojë këshillim kërkimor për kryerjen e hetimeve/kërkimeve ose për kryerjen e studimeve për çështje të veçanta.

Raportet e Zyrës nuk janë thjesht një koleksion i pikëpamjeve të ekspertëve. Duke mbajtur në konsideratë faktin që këto raporte hartohen nga parlamentarët, raporti shkon përtej nivelit informatizues, duke përmbajtur propozime dhe rekomandime.

Nëse raportuesi e vlerëson të nevojshme, mund të organizohen seanca të hapura dëgjimi, me qëllim mbledhjen ose edhe përballimin e pikëpamjeve të kundërta të figurave dhe organizatave kryesore të përfshira në çështje. Përmbledhjeve të shkruara të këtyre takimeve mund t'i bashkëngjiten raportet.

- *Autoriteti hetues*

Ligji u jep raportuesve autoritet për të kontrolluar pa paralajmërim dokumentacionet e të gjitha institucioneve nën kontrollin e shtetit dhe për të kërkuar të gjitha të dhënat zyrtare, më përjashtim të dokumenteve që lidhen me mbrojtjen kombëtare ose sigurinë e shtetit. Për më tepër, nëse raportuesit hasin vështirësi gjatë kryerjes së detyrës së tyre, ata mund të kërkojnë të përfitojnë nga të njëjtat të drejta, si edhe anëtarët e komisioneve hetimore.

Pasi kryhet studimi, reporterët u paraqesin anëtarëve të Zyrës një raport paraprak (projekt). Raporti duhet të hartohet në mënyrë të tillë që mund të përdoret për kryerjen e punëve legjislative ose për debate në lidhje me buxhetet. Anëtarët vendosin më pas nëse duhet ose jo ta publikojnë punimin, si dhe një pjesë ose të gjithë përmbledhjen e seancave të dëgjimit. Është për t'u theksuar se vendimet e Zyrës në shumicën e rasteve merren në mënyrë të njëzëshme, pasi ky institucion zakonisht arrin një konsensus në lidhje me çështjet që merr në shqyrtim.

Raportet e kësaj Zyre shpërndahen në të njëjtën mënyrë si dokumentet e tjera parlamentare; raportet mund të shiten në standin e Asamblesë Kombëtare dhe në Bibliotekën e Senatit; si dhe botohen në Gazetën Zyrtare.

Veprimtaritë e përgjithshme dhe ndërkombëtare

Kjo Zyrë gradualisht po bëhet një forum i zakonshëm për informacionin parlamentar, gjenerimin e ideve dhe të veprimeve në fusha të caktuara. Disa ligje theksojnë se Zyra duhet të informohet ose duhet të përfshihet në

emërimin e përfaqësuesve të Parlamentit në institucione/grupe të ndryshme ose duhet të përfaqësohet nga kryetari i saj, ose nga një nga anëtarët në bordet e institucioneve të ndryshme.

Zyra shihet, gjithashtu, si një partnere e mirë nga e gjithë bashkësia shkencore me të cilin ajo është në kontakt të vazhdueshëm. Veprimtari të organizuara nga Zyra në bashkëpunim me institucione të nivelit të lartë si Akademia e Shkencave, Komisioni Francës për Energjinë Atomike, Qendra Kombëtare për Kërkime Shkencore etj., janë shembuj të këtij partneriteti.

Çdo vit Zyra angazhohet në disa ditë studimi. Këto studime mund të jenë të lidhura me një nga raportet e saj ose me një temë teknologjike ose shkencore.

Zyra ndikon, gjithashtu, në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare të Parlamentit dhe merr pjesë në kongrese dhe veprimtari të ndryshme, veçanërisht në Europë. Për këtë arsye disa vite më parë u krijua një rrjet për bashkërendimin dhe shkëmbimin e informacionit, European Parliamentary Technology Assessment (EPTA). Kjo agjenci krijon lidhjen midis institucioneve europiane të ngarkuara për kryerjen e vlerësimeve teknologjike dhe shkencore për parlamentet kombëtare dhe Parlamentin European.

Në vitet në vazhdim, Zyra dëshiron të intensifikojë punën e saj, duke synuar thellimin e dialogut midis botës shkencore dhe politike.

Kjo zyrë ka publikuar rreth 50 raporte që nga krijimi i saj. Aktualisht ajo po punon për 13 studime.

2. Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Legjislacionit

Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Legjislacionit është krijuar në bazë të ligjit nr. 96-516, datë 14 qershor 1996.

Kjo zyrë përbëhet nga dy delegacione. Një nga delegacionet është formuar në Asamblenë Kombëtare, ndërsa tjetri në Senat. Secili nga delegacionet përbëhet nga Kryetari i Komisionit për Legjislacionin dhe një anëtar nga secili nga komisionet e përhershme (*ex officio*), si dhe nga tetë anëtarë të zgjedhur nga grupet parlamentare, në mënyrë të tillë që të sigurojnë një

përfaqësim proporcional, pasi anëtarët *ex officio* janë marrë në konsideratë.

Kjo Zyrë kryesohet në bazë të një sistemi rotacioni njëvjeçar midis Kryetarit të Komisionit për Legjislacionin të Asamblesë dhe Kryetarit të të njëjtit Komision në Senat.

Kërkesa për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme mund të hartohen nga Byroja ose nga Parlamenti, me nismën e tij, me kërkesën e një drejtuesi të një grupi politik ose me kërkesën e një komiteti të përhershëm ose të specializuar.

Raporti i parë i publikuar në maj 1999 trajtonte «L'exercice de l'action civile par les associations» (Ushtrimi i veprimtarisë civile nga organizatat) (raportues z. Pierre Albertini, deputet), i ndjekur në dhjetor 2001 nga një tjetër raport për «La prevention et le traitement des difficultés des entreprises» (Parandalimi dhe trajtimi i problemeve në sektorin e korporatave) (raportues z. Jean-Jacques Hyst, senator).

3. Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Politikave të Shëndetit

Zyra Parlamentare për Vlerësimin e Politikave të Shëndetit është themeluar kohët e fundit në bazë të ligjit për Financimin e Sigurimeve Shoqërore për vitin 2003 (ligji nr. 2002-1487, datë 20 dhjetor 2002). Qëllimi i kësaj Zyre është të informojë Parlamentin për pasojat e vendimeve në lidhje me politikat e shëndetit, në mënyrë që të sigurojë një proces vendimmarrjeje të realizuar në kushtet e një informacioni të plotë. Për këtë qëllim ajo mbledh informacion, angazhohet në programe studimi dhe kryen vlerësime.

Kjo Zyrë përbëhet nga kryetarët e Asamblesë Kombëtare dhe të Komisionit të Senatit për Çështjet Sociale, raportuesit për këto komisione, të cilët merren me çështje të sigurimit shëndetësor brenda kuadrit ligjor të financimeve të sistemit të sigurimeve shoqërore (anëtarët *ex officio*), si dhe dhjetë deputetë dhe dhjetë senatorë të zgjedhur në mënyrë të tillë që të sigurojnë, brenda secilës Dhomë, përfaqësimin proporcional të grupeve, duke arritur në një numër të përgjithshëm prej 24 anëtarësh. Deputetët emërohen

në fillim të çdo legislature, ndërsa senatorët emërohen pas çdo rinovimi pjesor të Senatit.

Kjo Zyrë kryesohet në bazë të një sistemi rotacioni për një periudhë njëvjeçare nga njëri prej kryetarëve të komisioneve për Çështjet Sociale të Senatit dhe Asamblesë Kombëtare.

Zyra asistohet në punën e saj nga një bord ekspertësh i përbërë prej gjashtë anëtarëve të zgjedhur, duke u bazuar në njohuritë e tyre në sektorin e shëndetit publik. Anëtarët qëndrojnë në bord për një periudhë kohore prej tre vjetësh.

Kërkesat për shqyrtimin e një çështjeje mund të kryhen nga:

- Byroja ose Parlamenti, me nismën e tij, me kërkesën e drejtuesit të një grupi politik ose me kërkesën e 60 deputetëve dhe 40 senatorëve;
- një komision i përhershëm ose i specializuar.

Komisioni për Vlerësimin e Politikave Publike, pasuesi i Zyrës Parlamentare për Vlerësimin e Politikave Publike

Një Zyrë Parlamentare për Vlerësimin e Politikave Publike, e përbërë nga dy delegacione (një nga Asambleja Kombëtare dhe një nga Senati), u themelua në bazë të ligjit nr. 96-517, datë 4 qershor 1996.

Secili nga delegacionet përbëhej nga Kryetari dhe Raportuesi i Përgjithshëm i Komisionit të Financës, si dhe nga një anëtar i secilit nga komisionet e përhershme (anëtarët *ex officio*), tetë anëtarë të zgjedhur nga grupet politike në mënyrë të tillë që të sigurohet përfaqësim proporcional, pasi janë marrë në konsideratë anëtarët *ex officio*. Komisioni u kryesua mbi bazë rotacioni njëvjeçar nga kryetarë të Komisioneve të Financës të Asamblesë Kombëtare dhe Senatit. Kërkesat për kryerjen e studimeve për çështje të caktuara u kryen nga Byroja ose nga Parlamenti, me nismën e tij, me kërkesën e një drejtuesi të një grupi politik ose me kërkesën e një komisioni të përhershëm ose të specializuar.

Që nga themelimi i saj, kjo Zyrë ka publikuar katër raporte. Raporti i fundit është botuar në maj 1999 («*Investissements étrangers en France: l'évaluation du dispositif public de promotion*») (Investimet e huaja në

Francë: Një vlerësim i përpjekjeve për promotion publik) (reportues z. Serge Vincon, Senator).

Më pas kjo Zyrë u pasua nga Komisioni për Vlerësimin e Politikave Publike, i cili u themelua më 15 qershor 2000 (ligji nr. 2000-1352, në bazë të të cilit Zyra pushoi së ekzistuari).

Komisioni përbëhet nga 16 senatorë, të cilët i përkasin delegacionit të Senatit.

Disa vlerësime janë kryer që nga krijimi i Komisionit. Vlerësimet janë kryer me ndihmën e ekspertëve të jashtëm dhe grupeve të interesit.

II. DELEGACIONET: MUNDËSOJNË INFORMIMIN MË TË MIRË TË SENATIT

1. Delegacioni Parlamentar për Çështjet Demografike

Delegacioni Parlamentar për Çështjet Demografike u krijua pas ligjit nr. 79-1204, neni 13, datë 31 dhjetor 1979 për abortin.

Ai përbëhet nga 25 anëtarë: 15 deputetë dhe 10 senatorë. Anëtarët e delegacionit zgjidhen nga dy Dhomat e Parlamentit, në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim proporcional të grupeve politike. Deputetët emërohen në fillim të çdo legjislature, ndërsa senatorët emërohen pas çdo rinovimi pjesor të Senatit.

Delegacioni parlamentar vendos të informojë dy Dhomat në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Rezultatet e hapave të ndërmarrë për rritjen e numrit të lindjeve.
- Aplikimi i ligjeve për mjetet parandaluese.
- Aplikimi dhe impakti i ligjit për abortin.

Tradicionalisht, Qeveria duhet t'i raportojë çdo vit delegacionit në lidhje me hapat e mësipërm, ndërsa delegacioni, nga ana e tij, duhet të bëjë komente në lidhje me këto raporte dhe t'ua dërgojë këto raporte komisioneve kompetente parlamentare.

Rregullat e këtij delegacioni janë si më poshtë:

- Zyra e delegacionit, e cila përbëhet nga tre deputetë dhe dy senatorë, drejtohet nga një kryetar dhe katër zëvendëskryetarë.
- Delegacioni emëron tre raportues, të cilët janë përgjegjës për monitorimin e tri fushave të përmendura më sipër.
- Delegacioni shqyrton çdo vit raportin që përgatitet dhe që dorëzohet pranë tij nga Qeveria. Tre raportuesit dorëzojnë pranë delegacionit analizën e këtij dokumenti. Vëzhgimet e delegacionit përmbliidhen në një raport informativ, i cili u dërgohet anëtarëve të të dy Dhomave të Parlamentit dhe më pas publikohen.
- Pas çdo takimi të delegacionit organizohet një konferencë shtypi për pasqyrimin e punës së bërë dhe të vendimeve të marra nga delegacioni.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën tetor-nëntor 2003

Përgatiti: Alma Kondakçi

I. Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit “Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2002” (zhvilluar në seancë plenare në datat 23 dhe 27 tetor 2003)

Diskutimi i këtij Raporti u zhvillua paralelisht me projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2002”.

Në Raportin e tij, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Mustafa Kërçuku, pasqyron dukuritë, problemet dhe vlerësimet e kontrollit të ushtruar ndaj organeve dhe institucioneve shtetërore për zbatimin e Buxhetit të Shtetit, si dhe jep disa opinione e rekomandime për masat që mund e duhet të ndërmarrë Qeveria për rritjen e efektivitetit të shpenzimeve buxhetore dhe për parandalimin e faktorëve që frenojnë zhvillimin ekonomik të vendit. Në Raport theksohet se gjatë vitit 2002 janë bërë përpjekje për zbatimin e programit ekonomik e financiar të vendit. Edhe situata makroekonomike vlerësohet se ka pasur qëndrueshmëri dhe ka garantuar rritje të parametrave ekonomikë në krahasim me një vit më parë. Nga kontrollet e ushtruara gjatë vitit 2002 janë vërejtur dhe evidentuar raste të shkeljes së disiplinës financiare, kryesisht të natyrës së shmangies së subjekteve nga deklarimi dhe pagesa e tatimfitimit, të TVSH-së dhe mosvjelja e taksave nacionale. Në Raport theksohet se niveli i realizimit të të ardhurave nga akciza në sektorin e doganave e të tatim taksave përbën një shqetësim serioz. Më pas, në Raport pasqyrohen shkeljet ligjore në zbatimin e legjisllacionit doganor nga disa degë doganore që kanë efekte në Buxhetin e Shtetit. Në përfundim, në Raport

pasqyrohen disa rekomandime për përmirësimin e treguesve të projektbuxhetit të vitit 2004 dhe të administrimit financiar.

Gjatë shqyrtimit të të dy raporteve në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit dhe në seancë plenare nga disa deputetë u rivu në dukje çertifikimi që i bën Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit Raportit të Këshillit të Ministrave. Në përgjithësi, diskutantët vlerësuan Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si raporti më i mirë dhe më profesional i paraqitur prej tij. Nisur nga shkëljet ligjore të paraqitura në Raport, disa diskutantë kërkuan rritjen e angazhimit të Qeverisë për të luftuar dukuritë negative, veçanërisht në drejtim të shmangies nga pagimi i tatimit mbi fitimin nëpërmjet deformimit të të dhënave kontabile nga disa firma, madje edhe të paraqitjes së bilanceve me humbje nga disa prej tyre, të vjeljes së detyrimeve debitore të prapambetura, të përmirësimit të menaxhimit në drejtim të derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, të rritjes së shkallës së implementimit të investimeve kapitale etj.

Përfaqësuesit e Qeverisë theksuan se shkalla e bashkëpunimit midis Qeverisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit është në rritje, çka shprehet në rritjen e përqindjes së zbatimit të masave dhe rekomandimeve të kërkuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, që për vitin 2002 është rreth 70 për qind. Në përgjigje të kërkesës së disa deputetëve, sipas të cilëve Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet t'u japë zgjidhje problemeve, disa diskutantë të tjerë theksuan se detyrë ligjore e këtij institucioni është të furnizojë me fakte dhe të dhëna komisionet parlamentare dhe Kuvendin, detyrë të cilën ai e ka realizuar. Sipas tyre, është detyrë e Kuvendit që të japë zgjidhje për masat dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat nuk janë zbatuar nga ministritë dhe institucionet shtetërore.

Në përfundim, Kuvendi i miratoi të dy raportet për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2002.

II. PROJEKTLIGJE TË SHQYRTUARA NË KOMISIONET E PËRHERSHME TË KUVENDIT DHE NË SEANCË PLENARE

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”

Nëpërmjet këtij projektligji i jepet mundësi personave juridikë, punëdhënës në sektorët e vështirë të ekonomisë, të krijojnë institut pensionesh për profesionet e vështira ose të aderojnë në një institut të tillë. Njëkohësisht, me këtë projektligj i jepet mundësi punëmarrësve që, nëpërmjet derdhjes së kontributeve suplementare në këto institute, të dalin në pension pleqërie para moshës së caktuar dhe për një periudhë sigurimi më të vogël se ajo e caktuar në ligjin “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përherëshme të Kuvendit, deputetët propozuan disa ndryshime në disa nene të tij. Konkretisht, në Komisionin e Përherëshëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, deputetët u shprehën kundër nenit 3 të projektligjit, i cili ndalon punëdhënësit e degëve të vështira të ekonomisë, që kanë detyrime ndaj institucioneve të sistemit të administratës publike (taksave, sigurimeve shoqërore, sigurimeve shëndetësore etj), të krijojnë ose të aderojnë në një institut profesional pensionesh. Sipas tyre, dy çështje që janë pjesë e ligjeve të ndryshme dhe kanë objekte të ndryshme, nuk mund të bashkohen në një ligj. Ata u shprehën se nuk është e drejtë që mosrealizimi i disa detyrimeve të vendosura në një ligj të sjellë kufizime në ligje të tjera. Për personat që nuk zbatojnë ligjin parashikohen sanksione dhe nuk ka arsye që ata të privohen nga të drejtat që i jepen në ligje të tjera. Për këtë arsye, Komisioni i Përherëshëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit vendosi që neni 3 të shfuqizohet.

Një ndryshim tjetër që iu bë projektligjit ka të bëjë me nenin 10 të tij, në të cilin theksohet se “pagesa e të ardhurave nga investimet, që shkon për fondin rezervë, nuk taksohet”. Sipas deputetëve, kjo çështje nuk është objekt i këtij ligji, prandaj duhet të hiqet nga ky projektligj dhe të shtohet tek ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Krahas këtyre ndryshimeve, komisionet bënë edhe disa ndryshime të tjera. Projektligji u miratua nga komisionet e përhershme të Kuvendit dhe pritet të miratohet në seancë plenare.

2. Projektligji “Për statistikave publike”

Ky projektligj zëvendëson ligjin ekzistues nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”, të miratuar dhjetë vjet më parë, të cilit i kanë munguar disa elemente të rëndësishme që kanë të bëjnë me vendosjen në ligj të parimeve të statistikave publike, vendosjen e elementeve që duhet të përmbajë programi i statistikave publike dhe me miratimin e këtij programi nga autoriteti përkatës, me rolin e Institutit të Statistikave dhe detyrat e tij, me marrëdhëniet e Institutit të Statistikave me agjensitë statistikore dhe institucionet qendrore e vendore, me mbikëqyrjen e Institutit të Statistikave për të siguruar përputhjen midis programit dhe kërkesave të standardeve ndërkombëtare për statistikave publike.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit, deputetët theksuan se mungesa e elementeve të përmendura më lart është reflektuar në mungesën e besueshmërisë së informacionit të publikuar nga Instituti i Statistikave. Për këtë arsye, theksuan ata, për tregues të rëndësishëm ekonomikë e financiarë janë shfrytëzuar të dhënat statistikore të nxjerra nga misionet ndërkombëtare të akredituara në Shqipëri ose nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Duke qenë se mangësitë e mësipërme korrigjohen me këtë projektligj, komisionet e përhershme të Kuvendit e miratuan atë.

Një nga çështjet më të debatueshme për këtë projektligj ka qenë parashikimi në të i miratimit të pogramit të statistikave zyrtare nga Këshilli i Ministrave. Sipas disa deputetëve, duke qenë se ky program përbëhet nga të dhëna statistikore, të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në shkallë vendi, duke nxjerrë në pah dukuri thelbësore për vendimmarrësit, ai duhet të sigurojë transparencën e punës së Qeverisë. Nëse ky program do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, theksuan ata, nuk do të sigurojmë gjithmonë të dhëna transparente për punën e Qeverisë. Prandaj, në komisionet e përhershme të Kuvendit u vendos që programi i statistikave zyrtare të miratohet nga Kuvendi.

Veç ndryshimeve të mësipërme, pas diskutimit, komisionet e përhershme të Kuvendit bënë edhe një sërë ndryshimesh të tjera që kanë të bëjnë me përcaktimin më të qartë të statusit dhe detyrave të INSTAT-it, me riformulimin e parimeve të statistikave zyrtare, me parashikimin e ruajtjes së konfidencialitetit të statistikave zyrtare, me pasqyrimin e lidhjes midis statistikave zyrtare dhe atyre administrative dhe rolit të INSTAT-it në hartimin e metodologjive statistikore për prodhimin e statistikave administrative, me marrëdhëniet e tij me agjencitë statistikore, me saktësimin e nenit që bën fjalë për kundravajtjet administrative e gjobat etj.

Projektligji pritet të miratohet në seancë plenare.

3. Projektligji “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës”

Për çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronave në komisionet e përhershme të Kuvendit u shqyrtuan dy nisma ligjvënëse:

Së pari, projektligji i paraqitur nga nismëtarët Fatmir Mediu dhe Alfred Çako.

Së dyti, projektligji i paraqitur nga një grup deputetësh.

Këshilli i Ministrave e tërhoqi nismën e tij ligjvënëse.

Projektligji i parë synon kthimin pronarëve të ligjshëm ose trashëgimtarëve të tyre të së drejtës së pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara ose të konfiskuara pa të drejtë nga shteti si për periudhën 1944-1991, ashtu edhe për periudhën 1991-2003. Në projektligj përcaktohen mënyrat e kthimit dhe kompensimit të pronave ndaj pronarëve të ligjshëm.

Varianti tjetër i projektligjit është paraqitur nga një grup deputetësh, mbi bazën e punës së grupit të ekspertëve, nën asistencën e OSBE-së. Ai përshkohet nga tri parime themelore, që janë:

- Prona që është e lirë (e pazënë) t’i kthehet pronarit të ligjshëm.
- Prona që nuk është e mundshme për t’u kthyer, t’i kompensohet fizikisht pronarit të ligjshëm.
- Kur nuk ekzistojnë dy mundësitë e mësipërme, pronari të kompensohet në të holla.

Në komisionet e përhershme të Kuvendit çështjet më të debatueshme për këto dy projektligje kanë qenë:

- Qëndrimi ndaj ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, në bazë të të cilit shteti u ndau anëtarëve të kooperativave bujqësore, familjeve që punonin e banonin në ndërmarrjet bujqësore dhe familjeve me banim në fshat një sasi toke, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

Në projektligjin e parë parashikohet shfuqizimi i këtij ligji, me argumentin që shteti nuk kishte të drejtë të tjetërsonte tokën e pronarëve dhe personat që kanë përfituar tokë sipas këtij ligji, nuk mund të quhen pronarë. Projektligji i konsideron këta persona “qiramarrës” dhe e vë shtetin para detyrimit që t’ia kthejë tokën pronarëve të mëparshëm. Sipas nismëtarëve të projektligjit, duke qenë se ligji nr.7501 është zbatuar në masë shumë të vogël, vetëm 21.6 për qind, projektligji i paraqitur prej tyre ka faturë më të ulët financiare se varianti tjetër i tij, pasi ai tenton të përdorë më tepër kompensimin fizik, në krahasim me atë monetar. Gjithashtu, ky projektligj, sipas tyre, shmang korrupsionin.

Kundërshtarët e këtij mendimi, të cilët mbështesin variantin e dytë të projektligjit, theksuan se ligji nr.7501 nuk duhet shfuqizuar, duke njohur të drejtën e pronësisë për tokat e ndara në bazë të këtij ligji. Sipas tyre, ky ligj është në përputhje me Kushtetutën, pasi shpërndarja e tokës bujqësore punëtorëve të kooperativave bujqësore dhe fermave shtetërore në bazë të ligjit nr.7501 është bërë për realizimin e interesit publik, meqenëse ndihmonte në përmirësimin e shpërndarjes demografike të popullsisë në atë kohë, në rritjen e prodhimit bujqësor etj. Gjithashtu, ata u shprehën se ky projektligj është në përputhje me Kodin Civil, sipas të cilit të gjitha pronësimet mbi bazë ligjore konsiderohen të ligjshme. Mbështetësit e këtij mendimi përbëjnë shumicën e deputetëve.

- Një çështje tjetër e debatueshme ka të bëjë me përfshirjen në projektligj të çështjes së kthimit të pasurisë së luajtshme pronarëve të ligjshëm. Një pjesë e deputetëve mbrojnë idenë e kthimit të pasurisë së luajtshme pronarëve

të tyre të ligjshëm, ndërsa pjesa tjetër, e cila përbën shumicën, është shprehur që për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës së luajtshme të hartohet një ligj i veçantë, në çastin kur shteti të jetë i gatshëm të përballojë këtë proces. Sipas tyre, nëse kjo çështje do të përfshihej në këtë projektligj, do të krijonte pengesa dhe zvarritje në zbatimin e ligjit edhe për kthimin dhe kompensimin e pasurisë së paluajtshme.

· Sipas projektligjit të paraqitur nga deputetët republikanë, trojet e zëna me ndërtime banimi pas vitit 1991 u kthehen pronarëve. Kundërshtarët e këtij mendimi mbështesin variantin e dytë, sipas të cilit kthimi i këtyre trojeve pronarëve të tyre kondicionohet nga vlera e investimit të kryer mbi to. Në rast se vlera e investimit përbën deri në 100 për qind të vlerës së truallit, prona i kthehet subjekteve të shpronësuara, pasi ata të kenë paguar kundërvlerën e investimeve të kryera; në rast se vlera e investimit përbën më shumë se 100 për qind të vlerës së truallit, shteti ose personat e tretë ruajnë pronësinë, ndërsa subjektet e shpronësuara kompensohen.

Varianti i paraqitur nga përfaqësuesit republikanë nuk kishte mbështetjen e shumicës së deputetëve, prandaj ai nuk u miratua në komisionet e përhershme të Kuvendit. Komisionet e Kuvendit kanë miratuar në parim projektligjin e paraqitur nga grupi i deputetëve nën asistencën e grupit të punës së ngritur nga OSCE-ja dhe po shqyrtojnë projektligjin nën për nen.

KONTROLLI PARLAMENTAR

1. Mocion për debat me Kryeministrin kërkuar nga Grupi Parlamentar i PDR-së për liberalizimin e lëvizjes së shqiptarëve në Europë (zhvilluar në seancë plenare më 10 nëntor 2003)

Në këtë mocion për debat përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të PDR-së i kërkojnë Qeverisë Shqiptare një angazhim maksimal për të realizuar liberalizimin e lëvizjes së shqiptarëve në Europë. Për të realizuar këtë qëllim, ata i kërkojnë Qeverisë Shqiptare të bëjë përpjekjet e nevojshme teknike, administrative, legislative e logjistike, si të përshejtojnë procedurat që kanë

të bëjnë me regjistrimin e popullsisë, të profesioneve, të kartave të identitetit, me përafrimin e të dhënave individuale me ato të Bashkimit European, me përgatitjen dhe trajnimin e personelit të pikave të kalimit kufitar etj. Gjithashtu, mocionistët kërkojnë nga Qeveria jonë të paraqesë me dinjitet para Komunitetit European kërkesën për lëvizjen e lirë të shqiptarëve në Europë.

Pas shqyrtimit të këtij mocioni, Kuvendi miratoi një rezolutë me këtë objekt:

Nisur nga përmirësimi i klimës politike në Shqipëri, nga stabiliteti i saj politik, nga përpjekjet që ajo po bën për ndërtimin e institucioneve demokratike e të ekonomisë së tregut, duke vlerësuar kontributin e Shqipërisë për sigurimin e stabilitetit, të sigurisë e paqes në rajon, të bindur se liberalizimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve shqiptarë në vendet e Komunitetit European është një ndihmesë për forcimin e këtij Komuniteti në veçanti dhe të paqes e sigurisë në përgjithësi, Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës të Shqipërisë të përgatisë brenda një katërmujori projektin teknik dhe programin e përshtatshëm legjislativo-administrativ për lëvizjen e lirë të qytetarëve shqiptarë në vendet e Komunitetit European, së bashku me koston financiare dhe t'ia paraqesë Komisionit të Komunitetit European. Gjithashtu, Kuvendi i bën thirrje paramenteve dhe qeverive të vendeve të Komunitetit European ta përkrahin e mbështesin këtë kërkesë, shpreh angazhimin e vet për të realizuar në kohë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kërkesë dhe i kërkon qytetarëve shqiptarë të zbatojnë të gjitha procedurat dhe parametrat e kërkuar në zbatim të saj.

2. Interpelancë me Ministren e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Arta Dade, kërkuar nga deputeti Qazim Tepshi (zhvilluar në seancë plenare më 21.10.2003)

Objekt i kësaj interpelance ishte strategjia e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për mbrojtjen e zonave arkeologjike të Durrësit, pasi, sipas kërkuarit të interpelancës, në këto zona kohët e fundit janë kryer ndërtime.

3. Përgjigje nga Ministri i Industrisë dhe Energjitikës, Viktor Doda, për pyetjet e deputetit Astrit Bushati (zhvilluar në seancë plenare më 21.10.2003)

Ministri i Industrisë dhe Energjitikës, Viktor Doda, iu përgjigj pyetjes së deputetit lidhur me vendosjen në Shkodër të një regjimi të rreptë kufizimesh të energjisë elektrike dhe për realizimin e premtimit të dhënë banorëve të rrethit të Shkodrës për vendosjen e matësve të energjisë elektrike.

4. Përgjigje nga Ministri i Ekonomisë, Arben Malaj, për pyetjet e deputetit Nikollë Lesi (zhvilluar në seancë plenare më 3 nëntor 2003)

Objekt i kësaj seance pyetjesh ishin masat për vendosjen e rregullave të konkurrencës në fushën e medias së shkruar, mbështetur në ligjin “Për konkurrencën”, si dhe shitja e disa gazetave me çmim nën koston reale të prodhimit të tyre.

5. Përgjigje nga Ministri i Industrisë dhe Energjitikës, Viktor Doda, për pyetjet e deputetit Niko Faber (zhvilluar në seancë plenare më 3 nëntor 2003)

Ministri iu përgjigj pyetjeve të deputetit Niko Faber për përkeqësimin e ndjeshëm të furnizimit me energji elektrike të Korçës, si dhe për rregullat e zbatuara në lidhje me dhënien me koncesion të Hidrocentralit të Gjançit në Korçë dhe fituesin e tij.

6. Përgjigje nga Ministri i Industrisë dhe Energjitikës, Viktor Doda, për pyetjet e deputetit Pal Dajçi (zhvilluar në seancë plenare më 3 nëntor 2003)

Objekt i kësaj seance pyetjesh ishin situata energjitike aktuale në vendin tonë dhe ndërprerjet e energjisë elektrike në rrethin e Kurbinit.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligji nr. 8910, datë 6.6.2002 “Për ratifikimin e Konventës nr. 150 “Administrimi i punës, 1978” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”. Duke njohur domosdoshmërinë për respektimin e plotë të autonomisë së organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve, organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës thirri në Gjenevë Konferencën e Përgjithshme të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Kjo Konferencë miratoi më 26 qershor 1978 Konventën për Administrimin e Punës, 1978. Çdo anëtar që ratifikon këtë Konventë, në përputhje me kushtet e vendit, u siguron organizatave një funksionim efektiv në fushën e vetë sistemit për administrimin e punës, funksionet dhe përgjegjësitë e të cilave bashkërendohen siç duhet. Gjithashtu, çdo vend që ratifikon këtë Konventë duhet të marrë masat sipas kushteve të vendit, për të siguruar brenda sistemit të administrimit të punës, këshillime, bashkëpunime dhe bisedime ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave më të përfaqësuara të punëdhënësve e punëmarrësve dhe, kur është e përshtatshme, përfaqësuesit e punëdhënësve e të punëmarrësve. Konventa urdhëron që në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare dhe praktikave të vendit, organet kompetente, brenda sistemit të administrimit të punës, do të kontribuojnë për përgatitjen e praktikave kombëtare në lidhje me çështjet ndërkombëtare të punës, të marrin pjesë në përfaqësimin e shtetit

në lidhje me këto çështje dhe të kontribuojnë në marrjen e masave në nivel kombëtar në lidhje me to. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30 të vitit 2002, në faqen 935. Ligjit i bashkëlidhet Konventa nr. 150 dhe Aneksi I.

Ligji nr. 8911, datë 6.6.2002 “Për ratifikimin e Konventës nr. 178 “Inspektimi i punës (detarët), 1996” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”. Këshilli Administrativ i Zyrës Ndërkombëtare të Punës ka mbledhur në Gjenevë më 8 tetor 1996, në sesionin e saj të 84-të, Konferencën e Përgjithshme të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e cila më 22 tetor 1996 ka miratuar Konventën mbi Inspektimin e Punës. Kjo Konventë zëvendëson rekomandimin mbi Inspektimin e Punës (detarët), 1926. Kjo Konventë zbatohet ndaj çdo anijeje të regjistruar në territorin e një anëtari, për të cilin Konventa është në fuqi dhe anija mund të jetë pronë shtetërore ose private, e caktuar për qëllime tregtare, për transportin e mallrave ose të pasagjerëve, ose që përdoret për qëllime të tjera tregtare. Konventa i lë të drejtë legjislacionit kombëtar që të përcaktojë se cilat anije do të quhen anije deti për qëllime të kësaj Konvente. Gjithashtu, ajo i vë detyra çdo anëtar që të sigurojë një sistem inspektimi të kushteve të punës dhe të jetës së detarëve. Çdo anëtar ka detyrimin të kujdeset që të gjitha anijet e regjistruara në territorin e tij të inspektohen në intervale që nuk i kalojnë tre vjetët, me qëllim që të verifikohen kushtet e punës dhe të jetesës, nëse ato janë në përputhje me legjislacionin kombëtar. Inspektorët janë të pavarur dhe nuk ndikohen nga asnjë influencë e jashtme e padrejtë. Konventa vë detyrimin që legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë që të zbatohen me efektivitet sanksionet e duhura për shkelje të dispozitave ligjore, zbatimi i të cilave u takon inspektorëve. Për çdo inspektim të kryer, inspektorët i paraqesin një raport organit qendror të bashkëpunimit. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30 të vitit 2002, në faqen 940. Ligjit i bashkëlidhet edhe Konventa 178.

Ligji nr. 8912, datë 13.6.2002 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe së strukturës të formulës të privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelekom”. Ky ndryshim i vetëm ka të bëjë me një emërtim. Kështu, në nenin 6 të ligjit nr. 8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës të privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelekom” emërtimi “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” ndryshohet dhe zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë” dhe “Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve”. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 19.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32 të vitit 2002, në faqen 1031.

Ligji nr. 8913, datë 20.6.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit ndërmjet Qeverisë të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin pilot të zhvillimit të peshkimit”. Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit lidhet për një projekt pilot të zhvillimit të peshkimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA). Sipas nenit 2 të Marrëveshjes, Shoqata është dakord t’i japë huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në valutë të ndryshme të barasvlefshme me 4.400.000 USD. Data e përfundimit të kredisë do të jetë 30 shtator 2007 ose një datë e mëvonshme që përcaktohet nga Shoqata, e cila do të njoftojë menjëherë huamarrësin për këtë datë të mëvonshme. Marrëveshja parashikon në mënyrë të detajuar ekzekutimin e projektit, paktin financiar dhe dëmshpërblimet e Shoqatës. Në Kreun I, në tabela të veçanta përcaktohen kategoritë e artikujve që financohen nga fondet e Kredisë, alodimin e shumave të Kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që financohen në çdo kategori. Në anekset A dhe B të kreut I tregohet se si do të veprohet në llogarinë speciale, kur tërheqjet janë bërë dhe nuk janë bërë në bazë të raporteve të menaxhimit financiar. Në Kreun

Il bëhet përshkrimi i projektit, nga ku del se qëllimi kryesor është përmirësimi i porteve dhe qendrave të peshkimit dhe i menaxhimit të tyre, si dhe rehabilitimi i ekonomisë së koranit, vlerësimi i ripopullimit, realizimi i akuakulturës pilot të specieve detare dhe të ujërave të ëmbla, si dhe të specieve me vlera të larta etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 34 të vitit 2002, në faqen 1053. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja, Aneksi A dhe B.

Ligji nr. 8914, datë 20.6.2002 “Për ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes së Kredisë të Zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Rehabilitimi urgjent i furnizimit me ujë”. Marrëveshja e Kredisë të Zhvillimit për projektin e “Rehabilitimit urgjent të furnizimit me ujë” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) është miratuar me ligjin nr. 8629, datë 22.6.2000. Ligjit i është bashkëlidhur edhe Marrëveshja dhe të dy janë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, të vitit 2000. Me ligjin nr. 8914, datë 20.6.2002 miratohet një amendament që i bëhet Marrëveshjes. Në Listën 1, në pikën 2/1 shkronja “b” bashkëlidhur Marrëveshjes thuhet: “Pagesat e bëra për harxhimet nën kategorinë (1) për punimet e rehabilitimit, në qoftë se kontrata për operatorin privat nuk do të paraqitet deri në 31 dhjetor të vitit 2000.” Me amendamentin që bëhet, amendament, i cili miratohet me ligjin nr. 8914, datë 20.6.2002, kjo pikë ndryshohet si vijon: “Pagesat në shumën ekuivalente me 2.000.000 SDR të bëra për shpenzimet në kategorinë (1) (a) për punimet e rehabilitimit, në qoftë se kontrata për operatorin privat do të miratohet deri më 30 qershor të vitit 2002.” Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 33 të vitit 2002, në faqen 1045. Ligjit i bashkëlidhet edhe Amendamenti nr. 1.

Ligji nr. 8915, datë 27.6.2002 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999, nr. 8519, datë 30.7.1999, nr. 8552, datë 18.12.1999, nr. 8581, datë 17.2.2000, nr. 8651, datë 28.7.2000, nr. 8713, datë 15.12.2000, nr. 8840, datë 11.12.2001 dhe nr. 8858, datë 14.2.2002”. Të gjitha ndryshimet kanë të bëjnë me shtesa në taksë. Kështu, në nenin 2 ku renditen se cilat janë taksa kombëtare, pra në këtë kategori shtohen edhe: mbitaksa për importet e taksueshme, taksa mbi konsumin e karburantit dhe taksa vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës.

Në nenin 6, në pikën “I. Taksa kombëtare” shtohen shkronjat “u”, “v” dhe “x” që janë:

u. Mbitaksa për importet e taksueshme caktohet në masën 1 për qind për të gjitha mallrat e importuara dhe të taksueshme.

v. Taksa mbi konsumin e karburantit caktohet në masën 3 lekë për litër për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe për ata të prodhuar në vend.

x. Taksa vjetore për tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës caktohet në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në vit, e cila derdhet sipas afateve të përcaktuara për taksat vjetore.”

Ndryshimet që bëhen në nenin 9 tregojnë organet që ngarkohen me nxjerrjen e taksave kombëtare e këto organe janë: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në ligj përcaktohet në një nen të veçantë se të ardhurat nga këto taksa të përdoren vetëm për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës dhe se fondet e papërdorura brenda vitit mbarten në vitet e ardhshme. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 33 të vitit 2002, në faqen 1046.

Ligji nr. 8916, datë 27.6.2002 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8858, datë 14.2.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998

“Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999, nr. 8519, datë 30.7.1999, nr. 8552, datë 18.11.1999, nr. 8581, datë 17.2.2000, nr. 8651, datë 28.6.2000, nr. 8713, datë 15.12.2000 dhe nr. 8840, datë 11.12.2001”. Ligji nr. 8858, datë 14.2.2002 ka bërë ndryshime në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 (ndryshuar edhe me 7 ligje të tjera) në nenin 2 (pika 22) shkronjën “r” të nenit 6, shkronjën “o” të pjesës A të nenit 9, paragrafët numër 5 dhe 14 të nenit 10 dhe në Lidhjen 10. Të gjitha këto janë shfuqizuar. Sipas ligjit nr. 8858, datë 14.2.2002 këto shfuqizime hynin në fuqi më 1 korrik 2002, kurse me ligjin nr. 8916, datë 27.6.2002 shfuqizimet do të hynin në fuqi më 1 janar 2003. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 33, të vitit 2002, në faqen 1047.

Ligji nr. 8917, datë 4.7.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr. 8508, datë 7.7.1999, nr. 8519, datë 30.7.1999, nr. 8552, datë 18.11.1999, nr. 8581, datë 17.2.2000, nr. 8651, datë 28.7.2000, nr. 8713, datë 15.12.2000, nr. 8840, datë 11.12.2001 dhe nr. 8858, datë 14.2.2002”. Këto ndryshime kanë të bëjnë me taksën konsullore. Kështu në Lidhjen nr. 2, nëndarja I, pika 7, ndryshohet dhe për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, për shtetasit e huaj që nuk kanë nevojë për vizë. Taksa nuk do të jetë vetëm mbi bazën e reciprocitetit, por do të paguhet jo më shumë se 10 USD. Në këtë pikë (në pikën 7) shtohet pika 7/1, sipas të cilës kjo taksë nuk do të zbatohet për periudhën 1 maj deri më 1 nëntor. Ndryshime pëson edhe pika 9 e Lidhjes nr. 2, nëndarja I. Sipas ndryshimit nuk do të paguajnë taksë vize ose taksë hyrjeje, turistët individë njëditorë dhe ata të organizuar në grupe turistike njëditore. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38 të vitit 2002, në faqen 1147.

Ligji nr. 8918, datë 4.7.2002 “Për një shtesë në ligjin nr. 8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999”. Neni 7 i ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996 përcakton në mënyrë të detajuar kushtet për përfitimin e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në kushtet që përcakton ligji në fuqi, në fund të paragrafit të dytë të nenit 7, pas fjalëve “Në kohën e shërbimit aktiv përfshihet”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Koha si punonjës i reparteve të Radiozbulimit të Forcave të Armatosura që, sipas funksionimit organik, kanë kryer detyrën e punonjësit të drejtimit dhe të operatorit të radiozbulimit (punonjës posti) si punonjës civil para titullimit ose rritullimit si ushtarak aktiv. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.7.2002 dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38 të vitit 2002, në faqen 1148.

Ligji nr. 8919, datë 4.7.2002 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 8003, datë 28.9.1995 “Kodi Penal Ushtarak i Republikës së Shqipërisë”. Me ligjin e lartpërmendur janë bërë shumë ndryshime e shtesa si në pjesën e përgjithshme, ashtu edhe në pjesën e posaçme të Kodit Penal Ushtarak. Në tërësi janë bërë 2 shfuqizime, 6 zëvendësime, 13 shtesa dhe 17 ndryshime. Në 24 nene fjala “degradim” është zëvendësuar me fjalët “ulje në gradë” dhe në 37 nene fjalët “kohë lufte” janë zëvendësuar me fjalët “gjendje lufte”. Përsa i përket pjesës së përgjithshme, interes paraqesin sidomos shtesat e neneve në Kreun I që kanë të bëjnë me bazat e legjislacionit penal ushtarak dhe me detyrat e legjislacionit penal ushtarak. Po në pjesën e përgjithshme është shtuar neni 8/a, i cili përcakton se kur mund të jepet dënimi me burgim të përjetshëm dhe dënimi me vdekje në rastet e gjendjes së luftës ose të gjendjes së jashtëzakonshme. Në pjesën e posaçme ka

shumë shtesa, ndryshime e shfuqizime të diktuar nga ndryshimi i kushteve e rrethanave qysh nga viti 1995 kur u miratua Kodi Penal Ushtarak e deri sot. Me interes paraqiten ndryshimet që kanë të bëjnë me kundërshtimet e eprorit, me vjedhjen e pasurisë në repart ose në vendin e shërbimit, me falsifikimin e dokumenteve të luftimit, shpërdorimin e detyrës, vrasjen me dashje, plagosjen e rëndë me dashje, kanosjen serioze për vrasje, përdorimin e mjeteve luftarake të ndaluara, sjelljen brutale me të plagosurit, me të sëmuret e robërit e luftës etj. Ligji ka 38 nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38 të vitit 2002, në faqen 1149.

Ligji nr. 8920, datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”. Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin për të ndaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar. Detyrimet që rrjedhin nga kjo Konventë, shtetet palë do t’i zbatojnë në pajtim me parimet e barazisë së sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjera. Konventa përmban rregullat dhe detyrimet e shteteve palë për penalizimin e pjesëmarrësve në një grup kriminal të organizuar dhe penalizimin për pastrimin e të ardhurave nga krimi dhe masat për të luftuar pastrimin e parave. Për problemet e lartpërmendura, si dhe për korrupsionin, Konventa parashikon gjykimin dhe sanksionet, konfiskimin e marrjen e sendeve, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me konfiskimin. Një vend të veçantë në Konventë i kushtohet ekstradimit, ndihmës ligjore të ndërsjellë, mbrojtjes të dëshmitarëve dhe viktimave, rritjes së bashkëpunimit për zbatimin e ligjit dhe mbledhjes, shkëmbimit dhe analizës së informacionit mbi natyrën e krimit të organizuar. Gjithashtu, me rëndësi janë edhe pjesët e Konventës që flasin për trajnimin dhe ndihmën teknike, presioni që duhet bërë për parandalimin e krimit të organizuar ndërkombëtar, zgjidhjen e konflikteve etj. Konventës i bashkëlidhen dy protokolle. I pari ka të bëjë me parandalimin, përfitimin dhe

ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe i dyti ka të bëjë me luftën kundër trafikut të emigrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare, e cila plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 41 të vitit 2002, në faqen 1195.

Ligji nr. 8921, datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e Konventës nr. 174 “Parandalimi i aksidenteve të rënda në industri, 1993” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës””. Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës e thirrur në Gjenevë nga Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në sesionin e saj të 80-të miratoi më 22.6.1993 Konventën nr. 174 “Për parandalimin e aksidenteve të rënda në industri”. Qëllimi i kësaj Konvente është të parandalojë aksidentet e rënda nga lëndët e rrezikshme dhe të minimizojë pasojat e aksidenteve të tilla. Kjo Konventë nuk zbatohet për instalimet e mëdha bërthamore dhe uzinat që përpunojnë lëndë radioaktive dhe instalimet ushtarake. Sipas Konventës, kur nuk është e mundur të implementohen menjëherë të gjitha masat parandaluese e mbrojtëse që shprehen në të, çdo anëtar duhet të hartojë plane për implementimin me sukses të masave të sugjeruara. Çdo anëtar, në bazë të ligjeve dhe rregullave kombëtare duhet të formulojë dhe të shqyrtojë periodikisht një politikë koherente kombëtare në lidhje me mbrojtjen e punëtorëve, publikut dhe mjedisit kundër rreziqeve nga aksidentet e mëdha. Në pjesën e tretë bëhet fjalë për përgjegjësinë e punonjësve lidhur me evidentimin e çdo instalimi me rrezikshmëri të lartë, marrjen e masave për mbrojtjen e tyre nën kontroll dhe, kur është rasti, për të përgatitur një raport lidhur me gjendjen, raport i cili duhet t’u përcillet autoriteteve kompetente. Në fund të kësaj pjese flitet për raportimin e aksidenteve. Pjesa e katërt përmban detyrat e autoriteteve kompetente për përgatitjen e masave të

emergjencës jashtë zonës, kurse pjesa e pestë flet për të drejtat dhe detyrat e punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.8.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 40 të vitit 2002, në faqen 1183. Ligjit i bashkëlidhet Konventa nr. 174 “Parandalimi i aksidenteve të rënda në industri, 1993” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Ligji nr. 8922, datë 22.7.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe NATO-s”. Meqenëse Republika e Shqipërisë është një vend partner i Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC), Partneritetit për Paqe (P&P) është rënë dakord që ajo të këshillohet për çështje politike dhe çështje që lidhen me sigurimin. Gjithashtu, është rënë dakord që të zgjerohë dhe të intensifikojë bashkëpunimin politik e ushtarak në Europë. Bashkëpunimi efektiv në këto çështje kërkon shkëmbim të informacionit sensitiv ose të privilegjuar ndërmjet palëve dhe për një gjë të tillë është rënë dakord që ato (palët) do të mbrojnë dhe do të sigurojnë informacionin e palës tjetër dhe të mos ia japin këtë informacion dhe material palëve të treta pa miratimin e prodhuesit origjinal. Në këtë kuadër, Zyra e Sigurimit të NATO-s (NOS), duke vepruar dhe në emër të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe Komitetit Ushtarak të NATO-s, përgjigjet për marrjen e masave të sigurimit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer brenda bashkëpunimit. Marrëveshja e cila është nënshkruar në Bruksel më 26.7.1994 detyron palët që të sigurojnë njëra-tjetrën se janë të përgatitura të mbrojnë informacionin e marrë, siç kërkohet nga prodhuesi origjinal. Duke pasur parasysh se Këshilli i Atlantikut të Veriut ka kërkuar që shtetet partnere të mos shfrytëzojnë fasilitetet e dhëna nga NATO-ja për veprimtari të tjera që nuk përputhen me parimet e bashkëpunimit në kuadrin e partneritetit, dhe/ose dëmtojnë interesat kombëtare të vendeve anëtare të Aleancës, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka deklaruar angazhimin e saj, duke nënshkruar edhe “Kodin e Sjelljes” (Code of Conduct). Ligji ka 2

nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.8.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47 të vitit 2002, në faqen 1380. Ligjit i bashkëlidhet edhe “Marrëveshja e Sigurimit”.

Ligji nr. 8923, datë 22.7.2002 “Për ratifikimin e “Konventës financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Rediocredito Centrale, Itali për financimin e importit të energjisë elektrike””. Bazuar në Memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar më 17.4.2002 midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, kjo e fundit angazhohet për t’i dhënë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë një kredi financiare për maksimumin e shumës në euro, në masën 30 milionë, për financimin e importit të energjisë elektrike nga Italia, për të përballuar krizën energjitike në Shqipëri. Shlyerja e kësaj kredie do të bëhet me 42 këste principale të barabarta 6-mujore, me një normë interesi vjetor nominal 0.1 për qind. Konventa parashikon kohën se kur ajo do të bëhet efektive, afatin për disbursimin e Kredisë Financiare, kushtet për përdorimin e fondeve, shlyerjen e kredisë dhe pagesën e interesave etj. Marrëveshja Financiare do të jetë qeveritare dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian. Për çdo mosmarrëveshje midis palëve, në fillim do të bëhen përpjekje për zgjidhjen e tyre miqësisht, mandej në rast moskuptimi, do të zgjidhen në nivel qeveritar, dhe në qoftë se edhe kjo përpjekje do të dështojë, të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Arbitrazhi i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris, nga një kolegj i përbërë nga tre anëtarë. Konventës i bashkëlidhet Aneksi A që përmban modelin për pagesën e parë të disbursimeve, Aneksi B që përmban modelin e disbursimeve të dyta, të treta dhe të katërta dhe Aneksin C që përmban modelin e deklaratës së njohjes të borxhit dhe në fund ndodhet Tabela e Shlyerjeve me datat e maturimit, këstet e principalit dhe këstet e interesave. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.8.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47 të vitit 2002, në faqen 1382.

